

RAPORTI VJETOR 2019

Prioritetet e Institucionit për vitin 2020



AUTORITETI I
KONKURRENCËS

HYRJA	4
ASPEKTE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2019.....	4
FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS	6
PJESA E PARË	8
DREJTIMET KRESORE TË POLITIKËS SË AK PËR VITIN 2019.....	8
1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.....	8
1.2 Akte nënligjore të miratuara nga Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2019	13
PJESA E DYTË	15
ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS	15
2.1 Tregjet e monitoruara	15
2.2 Kontrolli i përqendrimeve	34
2.3 Tregjet e shërbimit / joprodhuese.....	40
2.4 Tregjet prodhuese.....	46
PJESA E TRETË.....	52
AUTORITETI I KONKURRENCËS PËRBALLË PROCESHEVE GJYQËSORE	52
3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (2019)	52
3.2 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Apelit (2019)	52
PJESA E KATËRT	53
ROLI I AK NË FORMULIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE TË TJERA - ADVOKACIA E KONKURRENCËS	53
4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt akteve normative.....	53
4.2 Advokacia e Konkurrencës	54
PJESA E PESTË.....	55
INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	55
5.1 Kontributi në kuadrin e Integritimit Evropian	55
5.2 Bashkëpunimi Ndërkombëtar	55
PJESA E GJASHTË.....	58
ORGANIZIMI I AUTORITETIT.....	58
6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës.....	58
6.2 Të ardhura të derdhura në buxhet dhe realizimi i buxhetit të miratuar për AK për vitin 2019	58
6.3 Rekrutimet	59
PJESA E SHTATË	62
PRIORITETET E AK PËR VITIN 2020	62
7.1 Prioritetet e AK për vitin 2020	62
7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE-së	62

LISTË SHKURTIMESH

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AK	Autoriteti i Konkurrencës
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
APD	Autoriteti Portual Durrës
BE	Bashkimi Europian
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BSH	Banka e Shqipërisë
CRESSE	Competition and Regulation Summer School and Conference
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
ECS	Energy Community Secretariat
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
FNT	Fuqi të ndjeshme në treg
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
FSHF	Federata Shqiptare e Futbollit
GLN	Gazi i Lëngshëm i Naftës
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
ICN	Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës
IPA	Instrumenti i Para-Zgjerimit i BE
IDP	Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informimit publik
KE	Komisioni Europian
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
KMK	Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit
Ligji nr. 9121/2003	Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OECD-GVH/RCC	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik për Evropën Juglindore
OSSHE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PLATZ	Bursa ndërkombëtare e karburanteve
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin European
QKT	Qendra e Kontrollit Teknik
QKTL	Qendra e Kontrollit Teknik të Lëvizshme
Rezoluta/2017	Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë e vitit 2017
RSH	Republika e Shqipërisë
SFJB	Shoqëri Financiare Jo-Bankë
TAIEX	Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit i BE
TIA	Tirana International Airport
UK	Ujësjetllës Kanalizime
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin
VKK	Vendime Komisioni i Konkurrencës

HYRJA

ASPEKTE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2019

Viti 2019 u karakterizua nga një sërë ngjarjesh dhe situatash brenda dhe jashtë vendit, të cilat me intensitetin e tyre dhe kohën e ndodhjes ndikuan në situatën e përgjithshme makro financiare të vendit.

Në rrafshin ndërkombëtar, ekonomia botërore pas një ngadalësimi në gjysmën e parë të vitit vlerësohet se ka hyrë në një fazë rikuperimi. Megjithatë, aktiviteti ekonomik ende përballet me një ambient sfidues, i pranishëm si në ekonomitë e zhvilluara, ashtu edhe në ato në zhvillim. Barrierat tregtare, Brexit dhe problemet strukturore në sektorin prodhues në disa vende, janë ndër faktorët me më shumë peshë në zhvillimet e vitit të kaluar si dhe në paqartësitë që karakterizojnë të ardhmen.

Në rrafshin kombëtar sipas të dhënave nga INSTAT, në tremujorin e tretë të vitit 2019, ekonomia shqiptare përshejtoji aktivitetin e saj duke regjistruar një rritje vjetore në nivelin 3.8%. Nga një këndvështrim sektorial, përshejtimi reflektoi sezonin e favorshëm turistik, ndërkohë që në terma të kërkesës agregate, reflektoi një shtim të konsumit dhe të eksporteve.

Gjithsesi, referuar vitit 2019 si një i tërë, mund të thuhet se shkalla e pasigurisë për të arritur vlerën e parashikuar 4% është relativisht e lartë. Përveç një ngadalësimi në gjysmën e parë të vitit, tërmeti i fund nëntorit të kaluar, vlerësohet si një rrezik i shtuar për aktivitetin e ekonomisë.

Presionet inflacioniste në ekonomi ishin të ulëta përgjatë gjithë vitit, duke reflektuar në vazhdimësi performancën nën potencial të ekonomisë si dhe ecurinë në rënie të çmimeve dhe të mallrave të importuara. Për rrjedhim, politika monetare ka vazhduar të jetë në krahun lehtësues ndërkohë që tregjet financiare janë të qetë, me norma interesi në rënie, me një kurs këmbimi të qëndrueshëm dhe kreditimit të shtuar të ekonomisë.

Politika fiskale ka vazhduar të ndjekë trajektoren konsoliduese në 11 muajt e parë të vitit 2019. Megjithatë, interes përbën fakti si do të ndikojë përballimi i situatës emergjente që krijoi tërmeti i 26 nëntorit, për vitin 2019 e përtej. Zhvillime pozitive pritet të verifikohen edhe në tregun e punës, në ecurinë e pagave si dhe në sektorin e jashtëm të ekonomisë.

Megjithatë, nga këndvështrimi i Autoritetit të Konkurrencës, me kujdes të veçantë po vlerësohet raporti i Bankës Botërore “Doing Business 2020”¹ dhe botimi i Forumit Ekonomik Global², “Global Competitiveness Report 2019”. Të dy indekset përkojnë me rënie në renditje të Shqipërisë, si për sa i përket ambientit të biznesit, ashtu dhe për sa i takon indeksit të konkurrueshmërisë. Bazuar në këto zhvillime, Autoriteti po analizon me kujdes çdo komponent të secilit prej të dy raporteve në mënyrë që në veprimtarinë tonë të vitit 2020, të faktorizojmë

¹ <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/32436/9781464814402.pdf>

² http://www3.weforum.org/docs/WEF_GlobalCompetitivenessReport2019.pdf

monitorime, inspektive, vlerësime ligjore dhe rekomandime me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjen e konkurrencës në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare.

Viti 2019 mbarti një mori sfidash dhe e ballafaqoi ekonominë tonë edhe me disa surpriza të pakëndshme. Pavarësisht kësaj, ekuilibri i përgjithshëm makroekonomik dhe financiar i vendit mbeti i paprekur. Ekzistojnë të gjithë premisat që me një kujdes pak të shtuar kostot e shkaktuara nga tërmeti të absorbohen plotësisht duke kthyer programin e rindërtimit në një oportunitet të ri për më shumë rritje dhe mirëqenie.

FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

Viti 2019 përbën një tjetër vit sfidues për ekonominë, tregjet, autoritetet dhe institucionet në Shqipëri. Nga ky prizëm, zhvillimet komplekse, ndikuan dhe orientuan edhe aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës, në përpjekjet e tij për të përmbushur me sukses përgjegjësitë ligjore të tij. Njësoj si më parë, në qendër të veprimtarisë së tij ka qenë funksionimi i tregjeve në mënyrë të lirë, të hapur, ku pjesëmarrësit respektojnë parimet e konkurrencës në dobi të rritjes ekonomike dhe mirëqenies së popullatës.

Konkurrenca e lirë përbën një nga shtyllat kryesore, që garanton epërsinë e ekonomisë së tregut. Në kuptimin figurativ, nëse tregu është i lirë dhe konkurrues, atëherë gara mes lojtarëve është e ndershme. Por jo vetëm. Ajo garanton efektivitet maksimal në përdorimin e kapitalit, fuqisë punëtore, kapaciteteve prodhuese dhe burimeve natyrore.

Mbështetur në këto parime thelbësore të veprimtarisë sonë, Autoriteti i Konkurrencës për gjatë gjithë vitit 2019, bazuar në prioritetet e tij, në problematika të caktuara të momentit, në sinjalizime të ngritura në media apo në rrugë të tjera komunikimi, në ankesa të qytetareve dhe të bizneseve ka monitoruar dhe hetuar në vazhdimësi segmente të caktuara të tregut. Më konkretisht gjatë vitit 2019 Autoriteti ka realizuar:


- **15 (pesëmbëdhjetë) procedura monitorimi**, nga ku veçojmë tregun e depozitimit dhe të devijimit të energjisë elektrike, tregun e transportit ajror, tregun e prokurimeve të rojeve fizike, tregun e sigurimeve, tregun e bankave dhe tregun e shërbimeve celulare.
- **11 (njëmbëdhjetë) procedura hetimore**, nga ku veçojmë tregun e shërbimeve bankare, tregun e mbushjes-zbrazjes në Portin e Durrësit, tregun e shërbimit stomatologjik, tregun e naftës bruto, tregun e miellit, tregun e taksive dhe tregun e energjisë.

E gjithë veprimtaria monitoruese dhe hetuese e Autoritetit është realizuar në përmbushje të vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës, organit vendimmarrës të institucionit. Më konkretisht, janë marrë 93 (nëntëdhjetë e tre) vendime të Komisionit të Konkurrencës, nga të cilat:

- 24 (njëzetë e katër) janë autorizime për përqendrime, nga të cilat 8 në tregun e brendshëm dhe 16 në tregun e jashtëm;
- 45 (dyzetë e pesë) vlerësime ligjore që lidhen me situatën në tregun e energjisë elektrike, të ujit, të telefonisë, të sektorit financiar e në shumë segmente të tjera.

Gjatë vitit 2019, Autoriteti ka derdhur në buxhetin e shtetit shumën **12,583,318 lekë**, e cila është derdhur si e ardhur nga përqendrimet (njoftim dhe autorizim përqendrimi), çka përbën 17% të buxhetit të Institucionit.

Vendimet e KK në vite 2004 - 2019



Viti 2020 përkon me një tjetër periudhë komplekse. Ekonomia shqiptare, do të përballlet me një tjetër vit sfidues ku ndërmjet të tjerash i duhet të rikuperojë edhe dëmet e shkaktuara nga tërmeti i fund vitit të kaluar. Nga ky këndvështrim, Autoriteti i Konkurrencës zotëron gjithë potencialin njerëzor për të përballuar të gjithë sfidat dhe për të përmbushur të gjithë objektivat ligjore të tij. Njësoj si në të kaluarën edhe gjatë këtij viti veprimtaria jonë do të synojë mbrojtjen e konkurrencës në të tre shtyllat e përcaktuara në ligj:

- Shmangien e marrëveshjeve të ndaluara (kartelet);
- Shmangien e abuzimit me pozitën dominuese;
- Kontrollit të bashkimeve ose përqendrimeve të ndërmarrjeve.

Në vazhdimësi Autoriteti do të jetë jo vetëm nxitës, por njëkohësisht do të jetë edhe avokat i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit.

Ju faleminderit,

Prof. Dr. Juliana Latifi

PJESA E PARË

DREJTIMET KRESORE TË POLITIKËS SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2019

1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna me Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018”, nr. 213/4, datë 04.04.2019, AK ka realizuar veprimtarinë e tij në këto drejtime:

Të monitorojë përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në tregjet e hetuara gjatë vitit 2018 e veçanërisht për kontratat koncesionare në fuqi, të cilat sjellin deformime të konkurrencës në treg, duke evidentuar dhe përlogaritur dëmin apo përfitimin real të konsumatorit publik.

AK ka zbatuar këtë rekomandim të Rezolutës.

Gjatë vitit 2019, AK ka vazhduar të monitorojë përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në tregjet e hetuara gjatë vitit 2018, **dhe veçanërisht 2 (dy) kontratat koncesionare:**

a. “SGS Automotive Albania” SHPK (koncesion)

Gjatë vitit 2019, AK, ka monitoruar zbatimin e vendimit të KK nr. 562, datë 25.10.2018, “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve, ndërmarrjes SGS dhe MIE”.

Nga monitorimi rezulton se 3 pikat e para të dispozitivit të vendimit të KK nr. 562, datë 25.10.2018 janë përmbushur nga ndërmarrja SGS Albania SHPK.

Po ashtu, MIE ka njoftuar AK se me miratimin e VKM nr. 880, datë 24.12.2019 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të RSH”, ka bërë ndryshimet e nevojshme ligjore për realizimin e rekomandimit, për liberalizimin e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në RSH.

Dëmi ekonomik i llogaritur, si rezultat i shkeljes së rregullave të konkurrencës në zbatim të nenit 9, pika 2, geramat (a) dhe (ç), të ligjit nr. 9121/200, është gjoba e vendosur ndërmarrjes SGS në masën 5.69 % të xhiros totale të ndërmarrjes për vitin paraardhës financiar (2017), përkatësisht në shumën 51,091,005 (pesëdhjetë e një milion e nëntëdhjetë e një mijë e pesë) Lekë, e cila është vjelë dhe është arkëtuar në Buxhetin e Shtetit.

b. “EMS Albanian Port Operator” SHPK (koncesion)

Gjatë vitit 2019, AK ka monitoruar zbatimin e vendimit të KK me vendimin nr. 567, datë 07.11.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënien e disa rekomandimeve për nxitjen e konkurrencës në këtë treg për MIE, APD dhe ndërmarrjen “EMS-Albanian Port Operator”.

Nga monitorimi i kryer gjatë vitit 2019 rezulton se nga ana e koncesionarit EMS vendimet e KK, janë zbatuar në mënyrë të moderuar.

Rezulton se rekomandimet e dhëna nga AK kundrejt MIE dhe APD nuk janë realizuar nga këto dy institucione, pavarësisht shkresave zyrtare që i janë çuar këtyre dy institucioneve, në mënyrë të vazhdueshme.

Nga monitori, rezulton se: **në respektim të Kontratës Koncesionare, sipas së cilës Koncesionari EMS APO nuk mund të transferojë detyrimet e tij pa miratimin paraprak nga Autoriteti Kontraktor (MIE) me të cilin është lidhur kontrata e koncesionit, vlerësojmë të rëndësishëm bashkëpunimin midis Koncesionarit EMS APO dhe Autoritetit Kontraktor (MIE) për nxjerrjen e një drafti të përbashkët, ku të reflektohen interesat e të gjitha palëve të interesuara.**

Në lidhje me tregjet e hetuara gjatë vitit 2018, dhe të monitoruara gjatë vitit 2019, janë:

a. Tregu i transportit ajror të udhëtarëve “Austrian Airlines”

Në zbatim të vendimit të KK nr. 525, datë 14.06.2018 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines dhe dhënien e disa rekomandimeve”, AK ka vijuar monitorimin e tregut të transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines. Monitorimi është realizuar çdo 4 muaj në lidhje me çmimet që ka aplikuar Austrian Airlines, numrin e ankesave që ka patur, raste të overbooking, për një periudhë 1 vjeçare.

Nga monitorimi rezulton se VKK nr. 525, datë 14.06.2018 është zbatuar në mënyrë të moderuar si dhe AK i është drejtuar përsëri ndërmarrjes Austrian Airlines duke kërkuar informacion, për të vijuar me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.

b. Tregu i rrjeteve të supermarketeve “Conad”

KK, me vendimin nr. 560, datë 15.10.2018 vendosi “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë si dhe vendosjen e disa detyrimeve ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK, për të shmangur çdo kufizim të konkurrencës nga aplikimi i përcaktimi i çmimeve të rishitjes. **Në këtë treg gjatë monitorimit është konstatuar zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KK.**

c. “EKMA Albania” SHPK

AK, gjatë vitit 2019 monitoroi zbatimin e vendimit KK nr. 572, datë 22.11.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës” ku konstatoi abuzimin me pozitën dominuese të ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës.

Nga monitorimi rezulton se nga ana e ndërmarrjes nuk janë përmbushur kushtet dhe detyrimet e përcaktuara sipas pikës II të vendimit të KK.

Dëmi ekonomik i llogaritur, si rezultat i shkeljes së rregullave të konkurrencës në zbatim të nenit 9, pika 2, germa (a), (c) dhe (ç) të ligjit nr. 9121/2003, është në masën 9.99 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar (2017), përkatësisht në shumën 43,168,617 Lekë.

Ky vendim është në procedurë gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ. Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë ka lënë në fuqi Vendimin KK nr. 572, datë 22.11.2018.

Gjithashtu, kërkesa e ndërmarrjes EKMA SHPK për sigurimin e padisë është rrëzuar në të dy shkallët e gjykimit.

d. Tregu i sigurimit të detyrueshëm motorik TPL

KK me vendimin nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme”, gjatë vitit 2019 ka realizuar monitorimin e këtij tregu, për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Në përfundim të periudhës së monitorimit KK vendosi: t’i kërkojë AMF zbatimin e VKK nr. 561, datë 15.10.2018, brenda një periudhe 6 mujore.

Rekomandimet e dhëna në vendimin nr. 561, datë 15.10.2018 të KK, janë realizuar nga AMF.

AK mirëpret rastet që do të paraqiten në të ardhmen nga AMF për të cilin konstaton sjellje antikonkurruese nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

e. Tregu i prokurimeve publike

KK me vendimin nr. 535, datë 17.07.2018 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve ‘Tea-D’ SHPK dhe ‘A.E.K. & CO’ SHPK për marrëveshje të ndaluar në tregun e prokurimeve publike”,

KK, ka llogaritur edhe dëmin ekonomik në lidhje me këtë marrëveshje të ndaluar. **Gjopa e vendosur nga KK me vendimin e mësipërm është ekzekutuar plotësisht** dhe vendimi është dërguar pranë APP-së, e cila informon AK se nëpërmjet vendimit nr. 2 dhe 3, datë 14.01.2019, **APP ka përjashtuar nga procedurat e prokurimit publik dy ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë marrëveshje të ndaluar duke zbatuar rekomandimin e KK.**

Të mbikëqyrë me prioritet dhe të dalë me rekomandime konkrete për tregjet me sensitivitet të lartë publik e ndikim social si: tregu bankar, tregu i shërbimeve spitalore dhe tregu farmaceutik, si dhe sektori i arsimit të lartë publik dhe privat.

AK është në proces zbatimi të rekomandimit sipas Rezolutës.

Gjatë vitit 2019 AK, ka realizuar procedurat hetimore, duke mbikëqyrur me prioritet tregjet me sensitivitet të lartë publik e ndikim social si më poshtë:

a. Sektori bankar

KK me vendimin nr. 592, datë 31.01.2019 vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore 01.01.2016 deri në 31.12.2018, nisur nga fakti se ky treg shfaq: qëndrueshmëri të pjesëve të tregut lidhur me depozitat dhe kreditë, shkallë të lartë përqendrimi në segmente të produkteve, norma shumë të ulta dhe të ngurtësuar të interesave të depozitave, norma të larta të interesit të kredive, *spread* disa herë më të lartë krahasuar me normën e interesit të depozitave, komisione dhe penalitete bankare të larta për ndërrimin e bankës (*switching cost*), komisione të larta për transfertat bankare në monedhë të huaj dhe norma të larta fitimi, etj.

Procedura hetimore ka përfunduar dhe pritet vendimmarrja e KK pas realizimit të seancave dëgjimore me ndërmarrjet nën hetim dhe institucionet rregullatore të tregut përkatës.

b. Tregu i shërbimeve Spitalore

KK, me vendimin nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”, vendosi fillimin e procedurës së vlerësimit të konkurrencës në shërbimin spitalor i cili përfshin shërbimin spitalor publik dhe shërbimin privat.

KK, i cili konkludoi se vlerësimi i tregut të shërbimit spitalor kërkon analiza shtesë, me vendimin nr. 669, datë 24.12.2019 vendosi vijimin e hetimit në këtë treg për të realizuar një vlerësim më të thelluar të legjislacionit që vepron në shërbimin spitalor privat dhe publik, duke përfshirë dhe të drejtat e veçanta dhënë nëpërmjet kontratave koncesionare apo PPP-ve; politikat e vendosjes së çmimeve të shërbimeve/ekzaminimeve dhe investimet në pajisje dhe teknologjinë; bashkëpunimin mes institucioneve të shërbimit spitalor me shoqëritë e sigurimit dhe skemat e rimbursimit, etj.

c. Tregu farmaceutik

Gjatë vitit 2019, AK ka filluar monitorimin e tregut farmaceutik i cili ka konsistuar në vlerësimin e bazës ligjore dhe nënligjore mbi të cilën funksionin tregu i importit, prodhimit, tregtimit me shumicë dhe në rrjetin e farmacive të barnave në RSH. Për një vlerësim gjithëpërfshirës dhe realizimin e një analize të plotë të konkurrencës në treg, AK ka hartuar planin e veprimit që konsiston gjithashtu në vlerësimin e strukturave të tregut sipas tre niveleve të tregtimit (import, prodhim; tregtim me shumicë nëpërmjet rrjetit të depove farmaceutike dhe tregtimin me pakicë, rrjeti i farmacive); hyrja në treg të barnave të importit nëpërmjet të drejtave të veçanta dhe ekskluzive; funksionimi i skemës së rimbursimit nëpërmjet Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; prokurimet publike për mbulimin e nevojave për barna të institucioneve shëndetësore; mënyrën e importit dhe tregtimit të barnave më të shtrenjta dhe barnave më të konsumuara etj.

Tregu farmaceutik do të jetë një nga **prioritetet** e punës së AK gjatë vitit 2020.

d. Sektori i Arsimit të Lartë

KK me vendimin nr. 573, datë 26.11.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë me qëllim kryerjen e një analize të plotë në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar, si nga IAL-të publike dhe ato private, si dhe respektimin e rregullave të konkurrencës në këtë treg. Gjatë procedurës së hetimit ka lindur nevoja për informacione shtesë dhe KK, me vendimin nr. 620, datë 13.05.2019, vendosi shtyrjen e këtij hetimi për të marrë informacion mbi burimet e të ardhurave të IAL-ve; rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave; cila është pjesa e buxhetit për mësimin, kërkimin, zhvillimin e personelit, pagat; metodologjinë e llogaritjes së kostos së studimeve, tarifës së studimit; kostos së programit të studimit; politikën dhe procedurën e dhënies së bursave; politikën e pagave të IAL-ve dhe strukturën e të punësuarve, etj.

Të nisë rishikimin e ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, me fokus përpuethshmërinë e plotë me legjislacionin e BE-së në fushën e konkurrencës, në kuadër të përgatitjes për anëtarësim në Bashkimin Europian, përshtatur me kushtet e reja të zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

AK ka zbatuar rekomandimin sipas Rezolutës.

Pranë AK, në kuadër të projektit IPA II të Bashkimit Evropian, po implementohet projekti i binjakëzimit IPA Twinning “*Forcimi kapaciteteve për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg*”, ku AK është përfitues dhe implementues është Autoriteti Spanjoll i Konkurrencës, CNMC.

Projekti ka filluar me zhvillimin e aktiviteteve përkatëse sipas komponentëve të përcaktuar në të, ku komponenti (1) është: Përmirësimi dhe përafrimi i kuadrit ligjor me legjislacionin e BE-së. Në kuadër të këtij komponenti, në datat 14-18 tetor 2019 është realizuar takimi i parë, ku është kryer analiza ligjore dhe janë evidentuar problematikat gjatë zbatimit të ligjit.

Të kontribuojë në sensibilizimin e mëtijshëm të publikut për rolin e Autoritetit në garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe njohjen më të saktë të publikut me fushën e veprimtarisë së Autoritetit.

AK ka zbatuar këtë rekomandim të Rezolutës.

AK në përmbushje të këtij detyrimi në periudhën tetor-dhjetor 2019 u realizuan këto aktivitete:

1. Konferenca “Konkurrenca dhe Sipërmarrjet”, me rastin e 15 vjetorit të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar,” e mbajtur në 14 nëntor 2019. Në këtë aktivitet u prezantua projekti i binjakëzimit IPA me titull “Forcimi i mëtijshëm i kapaciteteve të Autoritetit të Konkurrencës për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”, i cili po implementohet nga CNMC dhe FIIAP.
1. Tryezë e rrumbullakët në qytetin e Vlorës, në 25 nëntor 2019, në Universitetin “Ismail Qemali”, me temë: “*Të njohim konkurrencën dhe sfidat e saj*”.
2. Tryezë e rrumbullakët në qytetin e Shkodrës, në datë 11.11.2019, në Universitetin “Luigj Gurakuqi, me temë: “*Të njohim konkurrencën dhe sfidat e saj*”.

AK, gjatë vitit 2019, si përfitues i Projektit të BERZH “Asistencë teknike për AK, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia”, në zbatim të komponentit 1, të projektit “Strategjia për Advokacinë e Konkurrencës” ka nisur hartimin e Strategjisë së Advokacisë për AK.

Të vijojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Plan i Kombëtar i Integritimit Evropian (PKIE) në drejtim të përafrimit të legjislacionit me direktivat europiane në fushën e konkurrencës.

AK ka zbatuar këtë rekomandim të Rezolutës.

Në zbatim të Planit Kombëtar Për Integritimin Evropian 2019-2022, AK ka vijuar procesin e përafrimit të legjislacionit me direktivat europiane në fushën e konkurrencës si më poshtë:

1. KK me vendimin nr. 633, datë 26.06.2019 miratoi udhëzuesin nr. 3, datë 26.06.2019 “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e ligjit nr. 9121/2003”.³

³ Në përputhje me Direktivën 2014/104/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 26 nëntor 2014 “Mbi disa rregulla që rregullojnë veprimet për dëmet e ligjit kombëtar për shkelje të dispozitave të ligjit të konkurrencës të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian” (32014L0104/ OJ L 349, 5.12.2014).

Të pëqendrohet në trajnimin e stafit të AK-së në lidhje me vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta dhe sidomos në vlerësimin e procedurave të prokurimit publik për marrëveshjet e ndaluara në oferta.

AK e ka zbatuar rekomandimin sipas Rezolutës në këtë drejtim.

Gjatë 2019, AK, në kuadër të projektit financiar nga Bashkimit Evropian, IPA 2015 sipas komponentit (2) “Organizimi i trajnimeve dhe vizitave studimore”, janë zhvilluar trajnime për stafin e AK me fokus: vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta dhe sidomos në vlerësimin e procedurave të prokurimit publik për marrëveshjet e ndaluara në oferta.

Të jetë më proaktiv në vlerësimin ex-ante të projektligjeve, si dhe të njoftojë Kuvendin për vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës në lidhje me çdo akt ligjor që prek parametrat e konkurrencës, në fazën e shqyrtimit të tyre nga komisionet parlamentare përgjegjëse.

AK ka zbatuar këtë rekomandim sipas Rezolutës.

Gjatë vitit 2019, me kërkesë të institucioneve propozuese AK ka vlerësuar, në zbatim të nenit 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, projektligjet si vijon:

1. Projektligji “Për Sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
2. Projektligji “Për shërbimet e pagesave”;
3. Projektligji “Për tregjet e kapitalit”;
4. Projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

KK me vendimin nr. 645 datë 31.07.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të vendimit nr. 562 datë 25.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur:

1. Në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, t’i kërkojë MIE liberalizimin e tregut, duke qenë se Kontrata e Koncesionit datë 03.09.2009 “Për shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre në RSH” përfundon në 03.09.2019.
2. Të njoftojë Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për moszbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës me nr. 562, datë 25.10.2018 nga ana e MIE.

1.2 Akte nënligjore të miratuara nga Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2019

Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit dhe PKIE, gjatë 2019 AK miratoi aktet nënligjore si më poshtë:

1. Udhëzim nr. 3, datë 26.06.2019 “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e ligjit nr. 9121/2003”, përfaruar me Direktivën 2014/104/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 26 nëntor 2014 “Mbi disa rregulla që rregullojnë veprimet për dëmet e ligjit kombëtar për shkelje të dispozitave të ligjit të konkurrencës të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian”.⁴

⁴ https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.L_.2014.349.01.0001.01.ENG

Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, janë miratuar aktet nënligjore të mëposhtme:

2. KK me vendimin nr. 636, datë 04.07.2019 ka miratuar *“Mbi miratimin e “Kornizës së Procedurave të Autoritetit të Konkurrencës” (Competition Agency Procedures - CAP) në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN)”*.
3. KK me vendimin nr. 665, datë 16.12.2019 ka miratuar Rregulloren *“Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në AK”*.
4. KK me vendimin nr. 584, datë 24.01.2019 ka miratuar Rregulloren *“Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë AK”*.


PJESA E DYTË

ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS

2.1 Tregjet e monitoruara

AK në zbatim të nenit 28 të ligjit 9121/2003 ka realizuar monitorime, analiza dhe studime të tregjeve për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 15 monitorime. Tregjet e monitoruara kanë qenë:



3 (tre) tregje që nuk kanë kaluar në procedura hetimore:

Tregu i prodhimit, tregtimit me shumicë e pakicë, mbarështimit të pulave për mish dhe produktit pulë e freskët

Nisur nga një ankesë e ardhur pranë AK, e cila ngrinte shqetësimin mbi mënyrën e tregtimit të produktit “Pulë e freskët” nga një ndërmarrje që operon në këtë treg. Në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, u realizua monitorimi në tregun përkatës për të parë nëse ka elementë që kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën në këtë treg.

Në përfundim të monitorimit nga analiza e të dhënave të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, u konkludua se në tregun e prodhimit, tregtimit me shumicë dhe pakicë, mbarështimit të pulave për mish dhe produktit “Pulë e freskët” nuk ka shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës sipas nenit 8 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Tregu i prokurimeve publike për ofrimin e shërbimit të Rojeve Fizike

Nisur nga një ankesë e paraqitur nga shoqëria private e ruajtjes dhe sigurisë fizike “H. Security” lidhur me paraqitjen në grup me vlera të njëjta të ofertave në procedurat e prokurimit të

shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, në zbatim të neneve 28 dhe 29/1 të ligjit nr. 9121/2003 u realizua një monitorim në tregun përkatës.

Nga monitorimi rezultoi se paraqitja e ofertave me vlera të njëjta nuk do t'i mundësonte asnjë pale në marrëveshje një fitore të paracaktuar. Zgjedhja e ofertës fituese në këto raste realizohet në bazë të shortit me gogla, duke bërë që fituesi të jetë i paparashikueshëm dhe nuk mund të paracaktohet. Ofertat identike janë si pasojë e sjelljes së ndërmarrjeve të orientuara drejt çmimit minimal të përlogaritur sipas akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP dhe KPP (VKK nr. 407, datë 08.03.2016). Në përfundim të monitorimit rezultoi se nuk ka shenja për marrëveshjeje të ndaluar në oferta, në procedurat e prokurimit publik në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

KK me Vendimin nr. 640, datë 25.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë “Illyrian Guard” SHA” ka vendosur t'i rekomandojë shoqërisë “Illyrian Guard” SHA, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj të respektojë parimet e konkurrencës dhe dispozitat ligjore që burojnë nga ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe sidomos respektimin e nenit 9 të këtij ligji. Ky rast është shqyrtuar pas depozitimit të një ankese në AK.

Në lidhje me këtë treg AK ka realizuar edhe një seancë dëgjimore në datë 4.07.2019 me titullarin e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku janë diskutuar problematikat që ka ky treg.

Tregu i ngarkim-shkarkimit të anijeve hidrokarbure

Nisur nga një ankesë e paraqitur pranë AK nga ndërmarrja R.P.SHA, lidhur me tarifat e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve hidrokarbure të aplikuara nga ndërmarrja Porti MBM (Multi Buoy Mooring), në Porto-Romano, Durrës, në zbatim të nenit 28 dhe 29/1 të ligjit nr. 9121/2003 u realizua monitorimi dhe vlerësimi i kësaj ankese, lidhur me tarifat e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve hidrokarbure të aplikuara nga ndërmarrja Porti MBM.

Nga vlerësimi i ankesës rezultoi se:

- Ndërmarrja Romano Port SHA ka ekskluzivitetin e ofrimit të shërbimit të ngarkim-shkarkimit në zonën e “Porto Romano”, me kapacitet të kufizuar të përpunimit të anijeve që transportojnë hidrokarbure, deri në 20.000 ton për naftën dhe 3.000 ton për gazin e lëngshëm të naftës. Tarifat për shërbimet e ofruara nga kjo ndërmarrje miratohen paraprakisht nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) dhe nuk mund të ndryshohen në mënyrë të njëanshme nga ndërmarrja Romano Port SHA.
- Ndërmarrja Porti MBM, në bazë të kontratës koncesionare ka fituar të drejtën ekskluzive për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8 (tetë) metra, në Porto Romano Durrës, për një periudhë prej 35 vjetësh. Tarifat për shërbimet e portit MBM janë miratuar me Udhëzimin e Përbashkët të MIE dhe MFE nr. 5749/5, datë 10.09.2019 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës” dhe janë të njëjta për të gjithë përdoruesit e portit.

- KK me vendimin nr. 383, datë 17.11.2015 “Për disa rekomandime lidhur me kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)” ka dhënë rekomandimet përkatëse mbi përcaktimin e metodologjisë së tarifave për shërbimet portuale të ofruara nga ndërmarrja koncesionare Porti MBM”.
- Në vijim të këtij vendimi të KK nga ana e MIE si Organi Shtetëror i Autorizuar, me vendimin nr. 1, datë 03.05.2019 është miratuar “Rregullorja e funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse për shoqërinë koncesionare MBM”, në bazë të së cilës Porti MBM funksionon si port i hapur për trafikun ndërkombëtar detar, sipas standarteve të përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare Detare, në të cilat RSH është palë, si dhe në zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
- Gjithashtu MIE dhe MFE me Udhëzimin e Përbashkët nr. 5749/5, datë 10.09.2019 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës” kanë miratuar tarifat për shërbimet portuale të ofruara nga ndërmarrja koncesionare Porti MBM.

Sa më sipër, rezulton se: tarifat për shërbimet portuale të ofruara nga ndërmarrja koncesionare Porti MBM, janë miratuar me Udhëzimin e Përbashkët të MIE dhe MFE nr. 5749/5, datë 10.09.2019 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës”. Në këto kushte të dyja shoqëritë koncesionare janë vendosur në kushte të barabarta, pasi tarifat e tyre miratohen paraprakisht nga organet shtetërore përkatëse.

1 (një) treg i cili do të kalojë në procedurë hetimore për 2020

“Tirana Airport Partners SHPK”(koncesion)

KK me vendimin nr. 538, datë 20.07.2018 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror në RSH”, vendosi:

1. T’i rekomandojë Këshillit të Ministrave që t’i kërkojë Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA):

- Në zbatim të pikës 19.4, germa (a) të Kontratës së Koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar, në cilësinë e Organit Shtetëror të Autorizuar dhe në bashkëpunim me shoqërinë koncesionare, të rishikojnë Pagesat për Shërbimet e Aeroportit siç parashikohet çdo tre vjet.
- Për shkak të pozicionit të kompanisë koncesionare, si i vetmi ofrues i shërbimeve ndërkombëtare të transportit të pasagjerëve, OSHA të hartojë dhe aprovojë një metodologji/rregullore për vendosjen e tarifave të aeroportit, si edhe tarifat të jenë të orientuara drejt kostos.

2. T’i kërkojë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të Kuvendit të RSH mbështetjen Tuaj për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të këtij vendimi.

AK, gjatë vitit 2019, me qëllim realizimin e monitorimit të rekomandimeve të dhëna në tregun shërbimeve që ofron koncesionari i “Tirana International Airport”, i është drejtuar Autoritetit të Aviacionit Civil me shkresën nr. 294 prot., datë 26.04.2019 “Kërkesë për informacion”, ku i kërkon vënien në dispozicion të Raportit të Auditit për Koncesionarin e “Tirana International Airport”.

Autoriteti i Aviacionit Civil është përgjigjur me shkresën nr. 881/3 prot., datë 06.06.2019 duke dërguar pranë AK një kopje të Raportit Përfundimtar të Rishikimit të Pavarur Ekonomik të Kontratës Koncesionare të TIA-s.

Nga monitorimi është konstatuar se:

1. Tarifat e përcaktuara në anekset e kontratës janë të njëjta për të gjitha shoqëritë që përftojnë shërbim nga TIA;
2. Nga anekset e kontratave nuk arrihet të evidentohet nëse tarifat që përcaktojnë këto anekse janë të mbështetura në ndonjë metodologji të përcaktimit të këtyre tarifave për operatorët; mbështetur në koston e ofrimit të këtyre shërbimeve, detajime të elementëve përbërës të koston të cilat më pas janë reflektuar në vendosjen e këtyre tarifave;
3. Duhet të kemi një informacion në lidhje me tarifat që ofrojnë aeroporte të rajonit, ose tarifat që paguajnë të njëjtët operatorë që marrin shërbimin këtu në Shqipëri me tarifat që paguajnë nëpër aeroporte të tjera ku ofrojnë shërbimin;
4. Sipas raportit të Rishikimit të Pavarur Ekonomik të Kontratës Koncesionare të TIA-s vërehet një hendek apo diferencë midis tarifave të raportuara dhe atyre të audituara për tarifën e sigurisë që sipas shpjegimeve të TIA-s kjo lidhet me pagesën e “taksës së sigurisë” prej 25% që i paguhet Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil sipas marrëveshjes koncesionare.
5. Gjithashtu, sipas raportit të Rishikimit të Pavarur Ekonomik të Kontratës Koncesionare të TIA-s, vërehet se tarifat për shërbimet në tokë dhe ato për uljen dhe ngritjen e avionit janë dukshëm më të larta se sa normat e paraqitura në planin e biznesit të kompanisë.
6. Gjatë viteve të aktivitetit, TIA ka patur rritje të ndjeshme të numrit të pasagjerëve. Rritja mesatare e volumit të pasagjerëve nga viti 2005 në vitin 2017 ka qenë 14.8%.
7. Si rrjedhojë, në përfundim të periudhës së vlerësimit duket se TIA ka patur rritje të fitimeve si pasojë e të ardhurave të siguruara nga rritja e volumit të pasagjerëve dhe rritja e normës së manaxhimit të trafikut ajror, krahasuar me vendet e tjera. Si konkluzion i Rishikimit të Pavarur Ekonomik të Kontratës Koncesionare të TIA-s, normat e fitimit të kompanisë TIA janë më të larta se të vendeve fqinje.

Ky treg do të jetë një nga prioritetet e veprimtarisë të AK për vitin 2020.

1 (një) treg i monitoruar, për të cilin KK vendosi hapjen e hetimit paraprak:

Tregu i shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës

Monitorimi në tregun e të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës filloi pas depozitimit të disa ankesave. Nga monitorimi rezultoi se ky treg ka

problematika lidhur me caktimin e çmimeve. Për sa më sipër, me qëllim vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun e transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003, KK me vendimin nr. 609, datë 10.04.2019 vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës për periudhën kohore 1 janar 2018 - 31 mars 2019.

Në përfundim të hetimit, KK me vendimin nr. 667, datë 24.12.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në Tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës dhe dhënien e disa rekomandimeve”, vendosi si më poshtë vijon:

1. T’i rekomandojë MIE dhe MFE: a. Të rishikojë dhe përditësojë Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave (sot MIE dhe MFE), nr. 1726/3, datë 21.04.2008 “Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi” dhe unifikimin e të gjitha akteve që dalin në zbatim të këtij udhëzimi;
2. T’i rekomandojë Bashkisë Tiranë respektimin e hierarkisë së akteve normative, pas rishikimit dhe përditësimit të udhëzimit nga MIE dhe MFE, duke qenë se Këshilli Bashkiak përcakton nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave;
b. të kryejë verifikimin e subjekteve transportuese të licensuar në shërbimin taksi, duke bërë transparente në faqen zyrtare listën e të licensuarve dhe të regjistruarve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.;
3. T’i rekomandojë DPMK të kryejë plumbosjen e taksimetrit sipas tarifës së përcaktuar nga Vendimi i Këshillit Bashkiak për të gjithë ndërmarrjet e licensuara që operojnë në tregun e taksive të shoqëruar me numrin e serisë për çdo të licensuar dhe verifikimin e tyre periodik (brenda vitit).

10 (dhjetë) tregje të monitoruara në zbatim të VKK 2018-2019:

Tregu i sigurimeve për produktin kartoni jeshil

AK ka vijuar monitorimin në tregun e sigurimeve për produktin Kartoni Jeshil në zbatim të VKK nr. 623, datë 23.05.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit VKK nr. 499, datë 15.02.2018 për kartonin jeshil”.

Për realizimin e këtij monitorimi, i cili është akoma në proces është konstatuar se gjatë kësaj periudhe, shoqëritë e sigurimit kanë zbatuar të gjitha kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në VKK nr. 499, datë 15.02.2018, si dhe ky vendim ka pasur efekte pozitive në treg. Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur rritje të çmimit të kartonit jeshil nga siguresit, po ashtu as rritje të çmimit të rriskut, i cili miratohet nga AMF. Për eliminimin e policave fallco, tashmë polica e sigurimit karton jeshil, është e vetmja policë siguri që printohet me QR Code.

AK ka bashkëpunuar me AMF, BSHS dhe ndërmarrjet e sigurimit, duke kërkuar informacion për zbatimin e këtij vendimi dhe rritjen e konkurrencës në këtë sektor, për të gjithë periudhën e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes.

Tregu i sigurimeve për produktin TPL

KK, me vendimin nr. 637, datë 09.07.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit nr. 561, datë 15.10.2018 për produktin TPL e brendshme”, i cili ishte në zbatim të VKK nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme”, ka realizuar monitorimin e këtij tregu për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Në përfundim të periudhës së monitorimit KK vendosi: t’i kërkojë AMF zbatimin e VKK nr. 561, datë 15.10.2018, brenda një periudhe 6 mujore: të raportojë pranë AK për përmbushjen e rekomandimeve; monitorimin e sjelljes së shoqërive të sigurimit në tregun e TPL, pas përcaktimit të primeve të rrezikut nga AMF të ndryshme për çdo shoqëri siguri, duke raportuar pranë AK shitjet mujore për çdo shoqëri për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga muaji mars 2019; monitorimin e sjelljes së shoqërive të brokerimit dhe shoqërisë “Star Broker”, të licencuar nga AMF si ndërmjetës në sigurime, duke raportuar pranë AK shitjet mujore për çdo shoqëri për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga muaji mars 2019.

KK, në datën 25.07.2019 ka realizuar një seancë konsultative me Drejtorin Ekzekutiv Z. E. Koci, dhe përfaqësues të tjerë të AMF, në lidhje me zbatimin e vendimeve të KK, observacionet e AMF kundrejt këtyre vendimeve, si dhe gjetjen e mundësive për t’i dhënë zgjidhje problematikave në tregun e sigurimeve.

AK ka realizuar dy takime konsultative me AMF, në datat: 10.09.2019 si edhe me 11.09.2019 ku janë diskutuar përmbushja e rekomandimeve të VKK nr. 561, datë 15.10.2018 dhe VKK nr. 637, datë 09.07.2019 si më poshtë vijon:

- a. Të miratojë primin e riskut për çdo kompani siguri mbështetur në raportin e përgatitur nga aktuari i kompanisë, duke mos miratuar dhe orientuar një prim risku të njëjtë për të gjithë tregun e MTPL;
- b. Të verifikojnë nëse tregtimi i TPL në sistemet e tyre të shitjeve është në përputhje me rregullat e sjelljes së tregut të miratuara nga AMF, me qëllim shmangien e pasojave të padëshiruara për konkurrencën në treg;
- c. Të marrë masat për ndalimin e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
- d. Të marrë masat për të lejuar shfaqjen në sistemet e tregtimit që përdoren nga agjentët vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit vepron;
- e. Të ndalojë agjentët të tregtojnë për llogari të kompanive të tjera të sigurimit për të cilat nuk janë të licensuar;
- f. Në sistemet e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm të shmangen ndërhyrjet që nuk janë në përputhje me aktet nënligjore dhe rregullat e vendosura nga AMF, me

qëllim shmangien e një koordinimi të mundshëm të sjelljes midis ndërmarrjeve konkurrense.

- g. Të parashtrojë përpara Autoritetit të Konkurrencës duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore për çdo rast për të cilin konstaton sjellje antikonkurruese nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

AK, për zbatimin e këtyre rekomandimeve ka kryer korrespondencën me AMF si vijon më poshtë:

- AK, me shkresën nr. 222/14 prot., datë 08.10.2019 “Kërkesë për informacion” ka kërkuar zbatimin e rekomandimeve të VKK nr. 561, datë 15.10.2018;
- AMF, me shkresën e saj nr. 3602/11 prot., datë 09.10.2019 na informon në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të AK.

Nga monitorimi rezulton se:

- i. pika “a” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018: *“Të miratojë primin e riskut për çdo kompani sigurimi mbështetur në raportin e përgatitur nga aktuari i kompanisë, duke mos miratuar dhe orientuar një prim risku të njëjtë për të gjithë tregun e TPL”*

AMF, me Vendimet nr. 54, datë 27.03.2019 “Albsig”; nr. 55, datë 27.03.2019 “Ansig”; nr. 56, datë 27.03.2019 “Atlantik”; nr. 57, datë 27.03.2019 “Eurosig”; nr. 58, datë 27.03.2019 “Insig”; nr. 59, datë 27.03.2019 “Intersig VIG”; nr. 60, datë 27.03.2019 “Sigal Uniqa Group Austria”; nr. 61, datë 27.03.2019 “Sigma Interallbanian Vienna Insurance Group”, “Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përlllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti”, ka miratuar tabelat e primit të rrezikut për secilën shoqëri për produktin TPL.

Me Vendimin nr. 62, datë 27.03.2019 “Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përlllogaritjen e nivelit të provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti”, për kontratat TPL të sigurimit; për kontratat kufitare të sigurimit; dhe për kontratat kartoni jeshil.

Për sa më sipër, pika “a” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018 është zbatuar nga AMF duke miratuar prime rreziku individuale për çdo shoqëri.

- ii. pika “b” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018: *“Të verifikojë nëse tregtimi i TPL në sistemet e shitjeve të shoqërive të sigurimit është në përputhje me rregullat e sjelljes së tregut të miratuara nga AMF, me qëllim shmangien e pasojave të padëshiruara për konkurrencën në treg”*

AMF, me shkresën nr. 3602/11, datë 09.10.2019 “Përgjigje e shkresës tuaj Kërkesë për Informacion”, na informon se ka kryer inspektime pranë ndërmjetësve në sigurime, nga ku janë konstatuar dhe raste të shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me

kërkesat e nenit 38, të ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Gjithashtu, AMF ka propozuar ndryshime përkatëse në Rregulloren nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorrik”, të cilat janë miratuar me vendimin e Bordit nr. 188, datë 18.09.2018. Inspektimi i fundit për sistemet e shitjeve pranë shoqërive të sigurimit është kryer gjatë muajve korrik dhe shtator 2019. Gjatë kësaj periudhe grupi i punës ka propozuar plotësime të mëtijshme të dokumentacioneve me karakter teknik për sigurinë e informacionit dhe ofrimit të mëtijshëm të transparencës së sistemeve, të cilat janë përmbushur nga përfaqësuesit IT të shoqërive të sigurimeve, sipas raportimit të tyre.

Për sa më sipër, pika “b” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018 është zbatuar nga AMF duke bërë verifikimet përkatëse nëse tregtimi i TPL në sistemet e shitjeve të shoqërive të sigurimit është në përputhje me rregullat e sjelljes së tregut të miratuara nga AMF.

- iii. pika “c” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018: *“Të marrë masat për ndalimin e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”*”

AMF, me shkresën nr. 3602/11, datë 09.10.2019 “Përgjigje e shkresës tuaj Kërkesë për Informacion”, na informon se gjatë vitit 2019 janë marrë masa ndaj agentë/punonjës të shoqërive të sigurimit, për shkeljet e konstatuara gjatë tregtimit të policave të sigurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore konkretisht:

- Vendimi i Bordit nr. 5, datë 31.01.2019 “Për marrjen e masës administrative, ndaj agentit në sigurime pranë shoqërisë së sigurimeve “Ansig” SHA, Z. Astrit Puci”.
- Vendimi i Bordit nr. 23, datë 04.03.2019 “Për marrjen e masës administrative, ndaj agentit në sigurime pranë shoqërisë së sigurimeve “Sigal Uniq Group Austria” SHA, Zj. Makbule Hoxha”.
- Vendimi i Bordit nr. 24, datë 04.03.2019 “Për marrjen e masës administrative, ndaj agentit në sigurime pranë shoqërisë së sigurimeve “Eurosig” SHA, Zj. Rudina Skonja”.

Për sa më sipër, pika “c” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018 është zbatuar nga AMF duke marrë masa ndaj agentë/punonjës të shoqërive të sigurimit për shkeljet e konstatuara gjatë tregtimit të policave të sigurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore.

- iv. pika “e” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018: *“Të ndalojë agentët të tregtojnë për llogari të kompanive të tjera të sigurimit për të cilat nuk janë të licensuar”*

AMF, me shkresën nr. 3602/11, datë 09.10.2019 “Përgjigje e shkresës tuaj Kërkesë për Informacion”, na informon se gjatë inspektimit të fundit për sistemet e shitjeve i kryer gjatë muajve korrik dhe shtator 2019 është evidentuar se agentë të caktuar kanë vënë në dispozicion marrëveshjet përkatëse të lidhura midis shoqërive të sigurimit, sipas kërkesave të nenit 194, pika 2 e ligjit nr. 52/2014, parashikim i cili lejon që agentë të caktuar të një shoqërie sigurimesh të operojnë si agentë edhe për shoqëri të tjera sigurimesh: “veprimtaria e agentit mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord

me marrëveshje të shkruar midis tyre” si dhe në Rregulloren nr. 23, datë 26.02.2018, neni 5, pika 2.1.c, parashikohet se: “Çdo agjent i cili ka akses për shitje policash, të më shumë se një shoqërie sigurimi, duhet të ketë një kopje të marrëveshjes në ambientet e tij, e cila lejon aksesin në to;”.

Për sa më sipër, pika “e” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018 është zbatuar nga AMF, pas inspektimeve të cilat kanë evidentuar marrëveshjet përkatëse të lidhura midis shoqërive të sigurimit i cili lejon që agjentë të caktuar të një shoqërie sigurimesh të operojnë si agjentë edhe për shoqëri të tjera sigurimesh.

- v. pika “f” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018: *“Në sistemet e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm të shmangen ndërhyrjet që nuk janë në përputhje me aktet nënligjore dhe rregullat e vendosura nga AMF, me qëllim shmangien e një koordinimi të mundshëm të sjelljes midis ndërmarrjeve konkurrense”*

AMF, me shkresën nr. 3602/11, datë 09.10.2019 “Përgjigje e shkresës tuaj Kërkesë për Informacion”, na informon se sistemi i raportimit të shitjeve është krijuar si pjesë e qendrës së informacionit, në bazë të nenit 38, të ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, dhe qëllimi i këtij sistemi është dhënia e statistikave të besueshme, standardizimi i praktikave, shmangia e rasteve të mashtrimit dhe dëmshpërblimi i palës së dëmtuar në kohën dhe masën e duhur. Sistemi i shitjeve të policave të sigurimit administrohet nga çdo shoqëri sigurimi, të cilat furnizojnë sistemin e raportimit me të dhëna. AMF ka përmirësuar rregulloret dhe vazhdon monitorimin e sistemit të raportimit.

Për sa më sipër, pika “f” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018 është zbatuar nga AMF, duke konstatuar se qëllimi i sistemit është dhënia e statistikave të besueshme, standardizimin e praktikave, shmangien e rasteve të mashtrimit dhe dëmshpërblimin e palës së dëmtuar në kohën dhe masën e duhur.

- vi. pika “g” e dispozitivit të VKK nr. 561, datë 15.10.2018: *“Të parashitë përpara Autoritetit të Konkurrencës duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore për çdo rast për të cilin konstaton sjellje antikonkurrense nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”*

Rekomandimet e dhëna në pikën II, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, dhe “f” të dispozitivit të vendimit të KK nr. 561, datë 15.10.2018, janë realizuar nga AMF. Lidhur me germën “g” të këtij vendimi, AK mirëpret rastet që do të paraqiten në të ardhmen nga AMF për të cilat konstaton sjellje antikonkurrense nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

Tregu i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë

KK me vendimin nr. 562, datë 25.10.2018, “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e

disa rekomandimeve”, ka vendosur për shkelje të konkurrencës, konkretisht të nenit 9, pika 2, germa (a) dhe (ç), të ligjit nr. 9121/2003 gjobën në masën 5.69 % të xhiros totale të ndërmarrjes për vitin paraardhës financiar (2017), përkatësisht në shumën 51,091,005 (pesëdhjetë e një milion e nëntëdhjetë e një mijë e pesë) Lekë, e cila është vjelë dhe është arkëtuar në Buxhetin e Shtetit.

Gjithashtu, KK ka vendosur:

Detyrimin e ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK për të ndaluar shkeljen e konkurrencës dhe brenda 45 ditëve të marrë masat e nevojshme, si vijon:

1. Të zbatojë në mënyrë të menjëhershme detyrimin ligjor për ofrimin e shërbimit cilësor, të kënaqshëm, duke vënë në përdorim QKTL-të pranë QKT-ve me fluksin më të madh të klientëve;
2. Të vendosë në funksionim 100% të kapacitetit të të gjitha QKT-ve dhe QKTL-ve.
3. Heqjen e pikës tre nga Deklarata–Tip që nënshkruhet nga klientët para dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar;
4. Hartimi i një plani për rishikimin e rishpërndarjes së posteve të ofrimit të shërbimit, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe ngritjen e nivelit të shërbimit, në kuptimin që në ato QKT ku postet janë të papërdorura, apo në një nivel të ulët përdorimi, të mund të sillen drejt QKT-ve ku ka fluks më të lartë.
5. Të hartojë një plan masash për ofrimin dhe përmirësimin e shërbimit në tregun e kontrollit teknik për automjetet, me kushte më të mira tregtimi në përputhje me kontratën, dhe të njoftojë pranë Autoritetit të Konkurrencës;

Me shkresën nr. 377/7 prot., datë 25.10.2018 “Dërgim vendimi”, i është njoftuar ky vendim MIE dhe SGS.

Nga monitorimi rezulton se pika “1”; “2” dhe “3” e dispozitivit të vendimit nr. 562, datë 25.10.2018 janë përmbushur nga ndërmarrja SGS Albania SHPK. Për sa më sipër rezulton se pikat 4 dhe 5 të dispozitivit të vendimit nuk janë realizuar nga ndërmarrja SGS.

Me vendimin nr. 562, datë 25.10.2018 KK, i ka rekomanduar gjithashtu edhe MIE:

1. Liberalizimin e tregut në drejtim të ofrimit të këtij shërbimi, duke përfshirë edhe ofrimin e shërbimit të servisit, sikurse e ofron pjesa më e madhe e vendeve të BE.
2. Për kohën e vazhdimin të këtij koncesionari, brenda një afati prej 90 ditëve: a) të miratohet një rregullore për funksionimin dhe monitorimin e Koncesionarit SGS, ku të jenë përcaktuar në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat, shërbimet që ofrohen nga ana e Tij, b) miratimin e planit të investimeve vjetore, me qëllim që shërbimi të jetë cilësor dhe t’i përgjigjet trendeve të zhvillimit, për rritjen e fluksit të mjeteve çdo vit si edhe shpërndarjes së popullsisë.
3. Rishikimin e manualit teknik dhe sidomos të afatit të testimit të mjeteve për t’u pajisur me certifikatën e kontrollit teknik.
4. Plotësimi i akteve ligjore dhe nënligjore duke përcaktuar qartë rolin e organeve shtetërore në lidhje me marrëdhëniet midis ndërmarrjes Koncesionare, që ka në

menaxhim dhe administrim infrastrukturën e QKT-ve dhe mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis tyre nga organet rregullatore.

AK i është drejtuar MIE me shkresën nr. 85 prot., datë 30.01.2019, dhe shkresën e përsëritur me nr. 85/1 Prot, datë 12.03.2019, duke i kërkuar informacion lidhur me zbatimin e vendimeve brenda afatit 90 ditor nga zbardhja e vendimit. Në vijim, për këto dy shkresa AK nuk ka marrë përgjigje nga MIE. AK i është drejtuar sërish MIE me shkresën nr. 66/2 prot., datë 19.06.2019 e cila është përgjigjur me anë të shkresës nr. 6119/1 prot., datë 17.07.2019, protokolluar së brendshmi me tonën nr. 66/3 prot., datë 18.07.2019. Nëpërmjet kësaj shkrese MIE informon se në zbatim të pikës 3.3.1 të Kontratës Koncesionare, nuk ka patur kërkesë për zgjatje të periudhës së koncesionit nga SGS.

Për sa më sipër, KK me vendimin nr. 645 datë 31.07.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të vendimit nr. 562 datë 25.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur:

1. Në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, t’i kërkojë MIE liberalizimin e tregut, duke qenë se Kontrata e Koncesionit datë 03.09.2009 “Për shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre në RSH” përfundon në 03.09.2019.
2. Të njoftojë Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për moszbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës me nr. 562, datë 25.10.2018 nga ana e MIE.

MIE me shkresën nr. 7283/7 prot., datë 23.08.2019 “Kthim Përgjigje”, protokolluar me tonën nr. 66/6 prot, datë 26.08.2019, ka bërë me dije se SGS Albania SH.P.K, i ka kërkuar MIE me shkresën nr. 1154 prot, në datën 31.07.2019, zgjatjen e Kontratës Koncesionare në zbatim të pikës 3.3.1 të Kontratës Koncesionare, për arsye se:

- Procesi i dorëzimit të koncesionit do kapacitete pritëse të mirëpregatitura të cilat, kërkojnë burime financiare dhe njerëzore;
- Autoriteti Kontraktor duhet të njohë kapacitetet teknologjike, avantazhet dhe problematikat në mënyrë që shërbimi të vijojë të ofrohet me standardet e kërkuara nga kuadri ligjor.

AK, me shkresën nr. 66/8, datë 06.09.2019, i ka kërkuar MIE njoftimin e kontratës koncesionare shtesë për zgjatjen e afatit, pranë AK, në zbatim të nenit 69, pika 1, germa b, të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për vlerësim ligjor, ku AK të vlerësojë barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ, për t’i dhënë mundësinë të bëjë rekomandimet përkatëse lidhur me ndryshimin e përfundimit të kontratës në afatin e ri deri më datën 31.12.2020.

Në përgjigje për sa më sipër, MIE ka njoftuar AK se me miratimin e VKM nr. 880, datë 24.12.2019 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të RSH”, ka bërë ndryshimet e nevojshme ligjore për realizimin e rekomandimit, për liberalizimin e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në RSH.

Rekomandimet e dhëna në pikën 1 të dispozitivit të VKK nr. 645 datë 31.07.2019, janë marrë në konsideratë nga MIE si dhe tregu i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në RSH është liberalizuar.

Tregu i shërbimeve celulare

KK me vendimin nr. 635, datë 04.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve AKEP në tregun e shërbimeve celulare”, ka vendosur monitorimin e tregut të telefonisë celulare për një periudhë 6 (gjashtë) muaj, monitorim i cili përfundon në janar 2020.

Gjithashtu KK me vendimin nr. 661, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve AKEP përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”, vendosi për disa rekomandime drejt AKEP si vijon:

1. Përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”, të vlerësojë:

- Komentet e Vodafone Albania, depozituar në AKEP datë 18.06.2019 lidhur me Analizën e Tregut të shërbimeve celulare në përgjithësi.
- Të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit European për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2018/C 159/01) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik.

AK pas marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare” nga AKEP, do të vlerësojë përmbushjen e rekomandimeve dhënë me vendimin nr. 635, datë 04.07.2019.

Këshilli Drejtues i AKEP-it me vendimin nr. 10, datë 17.04.2019, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”. Lidhur me këtë dokument, KK me vendim nr. 634, datë 04.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve AKEP lidhur me dokumentin për këshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare””, vendosi t’i rekomandojë AKEP si vijon:

- i. Të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
- ii. Vendosjen e masave rregullatore përkatëse duke vendosur edhe masën rregullatore të mos-diskriminimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (on-net/off-net rule) për operatorin që ka pozitë dominuese dhe heqjen e masës rregullatore të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net për operatorët që nuk kanë FNT në tregun me pakicë.

- iii. Shmangien e subvencionimit nga të ardhurat e realizuara në tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nga operatorët me FNT në tregun e shitjes me pakicë, për aplikimin e tarifave nën kosto.

Tregu financiar

Në zbatim të vendimeve të KK, tregu i shërbimeve financiare ka qenë objekt monitorimi gjatë vitit 2019, konkretisht në tregun e shërbimeve të ofruara nga Subjektet Financiare Jobankë dhe bankat.

- KK, me vendimin nr. 537, datë 20.07.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitjes dhe transferimit të aksioneve të BFSE HOLDING B.V tek shoqëria AMRYTA CAPITAL LLP”, vendosi që tregu i shërbimeve financiare nga SFJB, të jetë objekt monitorimi për një periudhë një vit nga data e autorizimit të këtij përqendrim.

Monitorimi ka për qëllim vlerësimin e sjelljes së subjekteve në lidhje me interesat e kredive të ofruara, në të gjitha format, komisionet e aplikuara për shërbimet, si dhe fleksibilitetin e lëvizshmërisë së klientëve mes ofruesve të shërbimit. Nga analiza paraprake në këtë treg është konstatuar nivel i lartë i përqendrimit të tregut, norma të larta të interesave dhe komisioneve të aplikuara për shërbimet e ofruara. Tregu i shërbimeve financiare nga SFJB kërkon një analizë më të thelluar e të shtrirë në kohë dhe për këto arsye, ky treg do të jetë **prioritet** i punës së AK gjatë vitit 2020.

- KK me vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të TIRANA BANK SHA nga PIRAEUS BANK SA tek BALFIN SHPK dhe KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE”, vendosi autorizimin e këtij përqendrimi me kushte dhe detyrime dhe monitorimin e sjelljes së Tirana Bank për një periudhë 1 vjeçare.

Për vlerësimin e zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të dhëna, Banka Tirana me shkresën nr. 484/21 prot., datë 31.01.2020 “Dërgimi i informacionit sipas shkresës suaj nr. 484/20 prot., datë 15.11.2019”, ka depozituar pranë AK dokumentacionin e kërkuar. Sjellja e Bankës Tirana është në procedurë vlerësimi.

Tregu i shërbimeve spitalore

KK, me vendimin nr. 539, datë 24.7.2018 “Mbi ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Hygeia Hospital Tirana SHA nga Diagnostic and Therapeutic Centre of Athens, Hygeia S.A tek American Hospital SHA” vendosi monitorimin e shoqërisë American Hospital SHA për një periudhë 1 vjeçare.

Nëpërmjet korrespondencës shkresore drejtuar American Hospital dhe International Hospital (Spitali Hygeia), është realizuar monitorimi i sjelljes së dy spitaleve i cili ka konsistuar në analizën e çmimit të shërbimeve, shumëllojshmërinë e shërbimeve dhe vlerësimin e treguesve ekonomik të dy subjekteve. Nga vlerësimi u konstatua se pas realizimit të përqendrimit të dy spitalet kanë rishikuar çmimet e shërbimeve me trend në ulje. Spitalet ofrojnë shërbime me çmime të ndryshme nga njëri tjetri.

Vlerësimi i sjelljes së dy spitaleve është pjesë e procedurës së hetimit të përgjithshëm në shërbimin spitalor, sipas vendimit të KK nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në shërbimin spitalor”.

Tregu i rrjeteve të supermarketeve “Conad”

KK në zbatim të vendimit nr. 560, datë 15.10.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në RSH dhe vendosjen e disa detyrimeve ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK, realizoi monitorimin e këtij vendimi.

Nga vlerësimi i informacionit të raportuar nga Conad Albania rezultoi si më poshtë vijon:

- i. pika “2/a” e dispozitivit VKK nr. 560/2018, ndërmarrja “Conad Albania” SHPK ka hequr nga faturat e shitjes, çmimin e këshilluar dhe llogaritjen e marzhit teorik.
- ii. pika “2/b” e dispozitivit VKK nr. 560/2018, për të siguruar që sistemi kompjuterike si brenda dhe jashtë tij nuk lëshon fatura me çmime të rekomanduara dhe marzhe teorike, u realizua monitorimi në vend nga ku rezultojë se sistemi kompjuterik si brenda dhe jashtë “Conad Albania” SHPK, nxjerr fatura pa çmime shitje dhe marzh teorik,
- iii. pika “2/c” e dispozitivit VKK nr. 560/2018, “Conad Albania” me shkresën nr. 65/1 prot., datë 15.02.2019 është përgjigjur duke vënë në dispozicion të AK informacionin mbi masat e marra në përputhje me vendimin e AK-së.

Rekomandimet e dhëna në pikën 2, germet: “a”, “b”, “c,” të dispozitivit të vendimit nr. 560, datë 15.10.2018, janë realizuar tërësisht nga “Conad Albania” SHPK.

Tregu i transportit ajror, ndërmarrja Austrian Airlines

Në zbatim të vendimit të KK nr. 525, datë 14.06.2018 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines dhe dhënien e disa rekomandimeve”, AK ka vijuar monitorimin e tregut të transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines. Monitorimi është realizuar çdo 4 muaj në lidhje me çmimet që ka aplikuar Austrian Airlines, numrin e ankesave që ka patur, raste të *overbooking*, për një periudhë 1 vjeçare.

Gjatë monitorimit të këtij tregu Austrian Airlines:

- Nga data 05 tetor 2018 ka vendosur në stendat e kontrollit të biletave si dhe në portën e daljes (*boarding gate*) një version të qartë dhe lehtësisht të lexueshëm të të drejtave të pasagjerit e cila vjen në gjuhën shqip, anglisht dhe gjermanisht.
- Në rastet e refuzimit të hipjes në avion ose anulimi të fluturimit i jep çdo pasagjeri të dëmtuar një kartëvizitë me të gjitha detajet e kontaktit të departamentit përkatës që trajton ankesat; i njoftohet adresa e e-mail/numri i telefonit ku duhet të adresohet ankesa; i dorëzohet një fletushkë me të gjithë procedurën që duhet të ndjekë për të kryer ankesën dhe ndjekjen e saj deri në finalizim.

- Çdo pasagjeri që preket nga vonesa me të paktën 2 orë i njoftohet sipas publikimeve në aeroport dhe nga stafi supervisor në aeroport të drejtat e pasagjerit, së bashku me formularin e të drejtave të pasagjerit të dëmtuar.
- Çdo pasagjeri i sigurohet dokumenti me rrugën që duhet ndjekur për ankesën e rastit si dhe të publikuar edhe në faqen e internetit të kompanisë ku është publikuar në një seksion të veçantë e gjithë procedura që ndiqet për çdo rast të dëmtuar.
- Lidhur me minimizimin e sa më shumë të jetë e mundur për tregtimin e biletave mbi kapacitetin e avionit, Austrian Airlines nuk ka depozituar një informacionin të qartë mbi shifra konkrete, por shprehet se ka minimizuar në maksimum rezervimet mbi kapacitet.

Nga monitorimi lidhur me rekomandimet për Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) në zbatim të vendimit të KK nr. 525, datë 14.06.2018, ai shprehet se:

- AAC për sa i përket analizës së çmimeve të aplikuara nga transportuesit ajrorë me pozitë dominuese në treg, ato vendosen lehtësisht nga tregu dhe jo nëpërmjet një metodologjie të rregulluar.
- Nga monitorimi i realizuar nga vetë AAC është vënë re se informacioni i përgjithshëm mbi të drejtat e udhëtarëve shfaqet në mënyrë të qartë dhe të dukshme brenda aeroportit, me qëllim që të sigurojë që pasagjerët e pranishëm në aeroport të informohen për anulimin e fluturimit të tyre dhe për të drejtat e tyre.

Nga monitorimi rezulton se vendimi i KK nr. 525, datë 14.06.2018 është zbatuar në mënyrë të moderuar si dhe AK i është drejtuar përsëri ndërmarrjes Austrian Airlines duke kërkuar informacion, për të vijuar me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.

Tregu i depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS) ka paraqitur Shkresën më datë 19.10.2018, protokolluar pranë AK me nr. 601 prot., me objekt “Njoftim për një sjellje të mundshme anti-konkurruese dhe kërkesë për hetim” (“*Notification of potential anti-competitive conduct and request for investigation*”), në lidhje me dy procedura tenderuese që ka zhvilluar KESH, referuar: “Kontratës së depozitimit” lidhur midis KESH SHA dhe shoqërisë EFT AG dhe “Kontratës së devijimit” lidhur midis KESH SHA dhe shoqërisë GSA SHPK.

KK me vendimin nr. 588, datë 28.01. 2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrembërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003.

KK me vendimin nr. 644, datë 31.07.2019 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, ka vendosur:

1. Konstatimin e shkeljes së rregullave të konkurrencës që rrjedhin nga pozita dominuese e KESH, në drejtim të procedurave për lidhjen dhe zbatimin e :
 - a. Kontratës së devijimit të energjisë elektrike mes shoqërive KESH SHA dhe GSA SHPK.

- b. Kontratës së depozitimit të energjisë elektrike mes shoqërive KESH SHA me EFT AG.
- 2. Dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA:
 - a. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA në zbatim të vendimit nr. 93/2019 të ERE që të ndërpresë vazhdimësinë e këtyre dy kontratave.
 - b. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA që të njoftojë Sekretariatën e Energjisë në Vjenë për ecurinë e zbatimit të vendimit nr. 93/2019 të ERE.
 - c. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA që të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës për ecurinë e zbatimit të vendimit nr. 93/2019 të ERE.
 - d. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA, si operator me pozitë dominuese, për çdo kontratë të ardhshme, e cila vendos të drejta të veçanta ose ekskluzive për ndërmarrje (kompani) ose për produkte të caktuara, që të kërkojë një vlerësim paraprak nga KK.

KESH në zbatim të pikës 3, shkronja (d) të dispozitivit të vendimit të KK nr. 644, datë 31.07.2019, i drejtohet AK dhe ERE për vlerësimin e disa kontratave të dërguara pranë shoqërisë KESH për qëllime të krijimit të marrëdhënieve kontraktore, si:

1. *Kontratë “Për shkëmbimin e energjisë ndërmjet KESH dhe NOA ENERGY TRADE SHPK”*, me objekt furnizimin me energji elektrike nga KESH për NOA kur, për çfarëdo arsye, do të ketë ndërprerje me furnizim me energji të kontraktorëve dhe klientëve nga NOA dhe/ose kur NOA nuk mund të sigurojë shërbime interkonjeksioni dhe transmetimi nga OST SHA dhe OST e tjera ku kalon energjia e importuar për të plotësuar kushtet e furnizimit me energji ndaj klientit.

Palët në këtë kontratë bien dakord që KESH do të bashkëpunojë me NOA për energjinë që KESH mund të furnizojë/absorbojë për/prej NOA (energji të devijimeve) kur, për çfarëdo arsye, do të ketë devijime ndërmjet programit të importit dhe programit të furnizimit, për qëllimin e furnizimit me energji të kontraktorëve të saj dhe të klientëve.
2. *Kontratë “Për shkëmbimin e energjisë elektrike ndërmjet KESH SHA dhe shoqërisë tregtare të energjisë elektrike “ENERGY TO ENERGY” SHPK”*, me objekt krijimin e kushteve për optimizimin e kapaciteteve gjeneruese; përmirësimin e furnizimit me energji elektrike dhe cilësisë së punës së dy shoqërive palë në këtë kontratë; shkëmbimin e energjisë elektrike për efekt të përmbushjes së detyrimeve të palëve në këtë kontratë ndaj tregut të energjisë elektrike dhe situatës emergjente hidroenergjitike në rastin e prurjeve të mëdha në kaskadën e Drinit; furnizimin në situatë emergjente në rastin e thatësirave të mëdha. Palët në këtë kontratë bien dakord që KESH do të furnizojë me energji elektrike shoqërinë ETE të rënë dakord mes tyre.

AK në bashkëpunim dhe me ERE, ka vënë në dijeni KESH SHA se: nga vlerësimi i draft - kontratave të paraqitura u konstatua dhe se ato janë të njëjta në përmbajtje me kontratat e mëparshme për devijimin dhe depozitimin e energjisë elektrike për të cilat KK është shprehur me vendimin nr. 644, datë 31.07.2019 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, dhe si të tilla kufizojnë konkurrencën.

Monitorimi i sjelljes së ndërmarrjes KESH SHA vijon deri në muajin korrik 2020.

Tregu i qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës

KK më vendimin nr. 572, datë 22.11.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës” vendosi:

- I. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës.
- II. Gjykitjen e ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK për shkelje të rëndë të konkurrencës, konkretisht të nenit 9, pika 2, germa (a), (c) dhe (ç) të ligjit nr. 9121/2003, në masën 9.99 % të xhiros së ndërmarrjes të vitit paraardhës financiar (2017), përkatësisht në shumën 43,168,617 Lekë.
- III. Detyrimin e ndërmarrjes “EKMA Albania” SHPK për të ndaluar shkeljen e konkurrencës dhe brenda 30 ditëve të marrë masat e nevojshme, si vijon:
 1. Hartimin e kontratave të qirasë bazuar në dispozitat e Kodit Civil (për kontratën e qirasë) për të vendosur palët e saj, qiramarrësin dhe qiradhënësin në kushte të barabarta kontraktuale në zbatim të ligjit dhe zakoneve të mira tregtare.
 2. Qiradhënësi të aplikojë çmime të arsyeshme të orientuara drejt kostos dhe çmimit mesatar të qirasë të zonës gjeografike.
 3. Qiradhënësi të jetë transparent në detajimin e zërave dhe vlerave përkatëse që përfshihen në faturën e qirasë së ambientit.
 4. Ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK të ndalojë menjëherë faturimin mbi çmimin ligjor të miratuar nga institucionet kompetente (faturuar nga OSHEE dhe UKT).
- IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën III të këtij vendimi, ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të ligjit nr. 9121/2003.
- V. Në rast se ndërmarrja “EKMA Albania” SHPK nuk ndërpret shkeljen e nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 dhe nuk vepron në përputhje me detyrimet dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, KK vendos gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, derisa ndërmarrja EKMA Albania SHPK të veprojë në përputhje me këtë vendim, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) dhe (c) të ligjit nr. 9121/2003.

Për zbatimin e këtij vendimi në lidhje me pikën II të tij, AK gjatë vitit 2019 ka marrë pjesë në procedurat gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, e cila me vendimin nr. 523, datë 19.02.2019 la në fuqi vendimin e AK. Ndaj vendimit të AK ndërmarrja “EKMA Albania” ka kërkuar edhe sigurimin e padisë që është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 97, datë 18.06.2019.

Nga monitorimi i realizuar në ambientet e ndërmarrjes EKMA SHPK, rezulton se nga ana e ndërmarrjes nuk janë përmbushur kushtet dhe detyrimet e përcaktuara sipas pikës II të këtij vendimi.

Për këtë arsye, KK, me shkresën nr. 365/50, datë 23.10.2019 ftoi ndërmarrjen “EKMA Albania” për ta dëgjuar në seancë dëgjimore pranë AK për të parashtruar masat e marra lidhur me zbatimin e VKK nr. 572, datë 22.11.2018.

Duke qënë se, në këtë seancën dëgjimore të planifikuar nuk u paraqit asnjë përfaqësues i ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, AK, me shkresën nr. 365/51 prot., datë 13.11.2019 kërkoi informacion nga ndërmarrja lidhur me masat për përmbushjen e detyrimeve sipas VKK nr. 572, datë 22.11.2018, shkresë për të cilën nuk u kthye asnjëherë përgjigje.

AK me shkresën nr. 365/52, datë 18.12.2019, përsëriti edhe njëherë kërkesën drejtuar ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, duke i vendosur afat deri më 10 janar 2020 për plotësimin e saj.

AK po monitoron ne vijimësi përmbushjen e detyrimeve ligjore në zbatim të ligjit nr. 9121/2003.

Tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit

KK, me vendimin nr. 567, datë 07.11.2018, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënien e disa rekomandimeve”, ka vendosur disa detyrimeve për ndërmarrjen EMS APO, monitorimin e sjelljes së kësaj ndërmarrjeje për një periudhë 1 (një) vjeçare, si dhe detyrimin e saj për të raportuar çdo 3 (tre) muaj pranë AK të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi dhe marrëdhëniet me palët e treta.

Lidhur me zbatimin nga ana e ndërmarrjes EMS APO të rekomandimeve të dhëna, sa i përket tre mujorit të parë të monitorimit, KK me vendimin nr. 608, datë 10.04.2019, “Mbi detyrimin për zbatimin e vendimit të KK nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK”, ka vendosur:

- (1) Të mos pranojë draft kontratën për kryerjen e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit në terminalin lindor në portin e Durrësit, të paraqitur nga EMS APO;
- (2) Koncesionari EMS APO në çdo rast nënkontraktimi të shoqërive të ngarkim shkarkimit për të operuar në terminal, në zbatim të kontratës koncesionare, duhet të aplikojë kushte të njëjta bashkëpunimi për nënkontraktorët, si dhe të vendosura në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës;
- (3) EMS APO për hartimin e draft kontratës, në respektim edhe të pikës I/b të vendimit të KK 567/2018, të bashkëpunojë me MIE, si Autoriteti Kontraktor, me qëllim nxjerrjen e një drafti të përbashkët;
- (4) EMS APO, në çdo raportim pranë AK-së, të paraqesë dokumente, prova, fakte për të vërtetuar deklaratimet e bëra prej saj lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna sipas pikës III të vendimit të KK 567/2018;
- (5) Ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në pikën (III) të VKK 567/2018, ndëshkohet me gjobë deri në

10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, të ligjit nr. 9121/2003.

Lidhur me zbatimin nga ana e ndërmarrjes EMS APO të rekomandimeve të dhëna, sa i përket tre mujorit të dytë të monitorimit, KK me vendimin nr. 641, datë 25.07.2019, “Mbi zbatimin periodik të vendimit të KK nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK”, ka vendosur:

(1) Ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK në respektim të VKK nr. 567/2018, pika I/b), si dhe vendimit të KK nr. 608/2019, pika 3, ta përcjellë draft kontratën e rishikuar për shërbimet stivadore pranë MIE, me qëllim bashkëpunimin për nxjerrjen e një drafti të përbashkët, ku të reflektohen interesat e të gjitha palëve të interesuara;

(2) Të njoftohet AK në lidhje me draft - kontratën e përbashkët nga ana e EMS-së.

Në vijim EMS APO ka raportuar mbi 3 mujorin e tretë dhe të katërt të periudhës nën monitorim (15 maj-15 gusht 2019; 15 gusht-15 nëntor 2019) lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna sipas vendimit të KK nr. 567/2018. Nga vlerësimi i informacionit të raportuar rezultoi se: EMS APO në respektim të VKK nr. 567/2018, pika I/b), VKK nr. 608/2019, pika 3, si dhe vendimit të KK nr. 641/2019 (pika 1), ka përcjell për rishikim dhe ndryshim pranë MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, draft kontratën e rishikuar për shërbimet stivadore në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit, me qëllim dakordësimin e një drafti përfundimtar i cili të reflektojë interesat e të gjitha palëve të interesuara. Por deri në raportimin e fundit EMS APO shprehet se ende nuk ka një përgjigje apo ftesë për konsultime nga MIE.

Bazuar sa më sipër, në respektim të pikës 2 të vendimit të KK nr. 641/2019, AK mbetet në pritje të variantit përfundimtar të draft-kontratës për shërbimet stivadore në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit, variant i cili do të pasqyrojë qëndrimin e MIE dhe interesat e të gjitha palëve që operojnë në tregun përkatës.


2.2 Kontrolli i përqendrimeve

AK, në zbatim të neneve 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121/2003, gjatë vitit 2019 ka realizuar vlerësimin e 42 rasteve të njoftuara të përqendrimeve, nga të cilat 24 janë autorizuar nga KK dhe 18 prej tyre nuk kanë plotësuar kriteret e ligjit nr. 9121/2003.

Sektorët e ekonomisë me numrin më të madh të transaksioneve për vitin 2019:



Nga vlerësimi i përqendrimeve rezulton se:



- 38% e rasteve të njoftuara janë transaksione që kanë ndodhur në tregun e jashtëm, 16 vendime autorizimi;
- 19% e rasteve të njoftuara janë transaksione, që kanë ndodhur në tregun shqiptar, 8 vendime autorizimi;
- 43% janë njoftime, të cilat nuk kanë përmbushur kriteret për t'u autorizuar nga KK, 18 vlerësime ligjore.

2.2.1 Transaksione në tregun e brendshëm

AK ka autorizuar 8 transaksione të njoftuara në tregun shqiptar të cilat, të detajuara sipas tregjeve, janë si më poshtë:

Tregu financiar

Në këtë treg, gjatë vitit 2019 janë vlerësuar 7 transaksione të ndodhura, nga të cilat 3 prej tyre kanë kaluar në procedurat e vlerësimit të përqendrimit, ku 1 transaksion ka ndodhur në tregun shqiptar.

- Përfitimi i kontrollit të Tirana Bank nga Balfin SHPK

KK, me vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje”, vendosi të autorizojë përqendrimin me kushte dhe detyrime për Tirana Bank dhe rekomandime për Bankën e Shqipërisë. Transaksion u klasifikua si përqendrim konglomerat i cili nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në tregun e shërbimeve bankare ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Pas vlerësimit të tregut përkatës, KK autorizoi përqendrimin e njoftuar me kushte dhe detyrime për Tirana Bank si më poshtë:

- a) Të mos zbatojë kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- b) Të mos vendosë kushte për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë;
- c) Të mos ushtrojë veprimtari bankare ose financiare me dhe në përfitim të personave të lidhur me të;
- d) Transaksioni të sigurojë efikasitet ekonomik dhe të japë siguri mbi qëndrueshmërinë e marrëdhënieve të punës së stafit ekzistues të Tirana Bank SHA.
- e) Gjithashtu u vendos t’i rekomandohet Bankës Qendrore të Shqipërisë që:
- f) Për çështje të stabilitetit financiar, të gjitha shoqëritë tregtare të kontrolluara nga Balfin SHPK, që zotërojnë pozitë dominuese ose që do të marrin në të ardhmen këtë pozitë, duhet të monitorohen dhe të trajtohen si aktivitete të lidhura me sistemin bankar, pavarësisht objektit të veprimtarisë së tyre.
- g) Të parashtrojë përpara AK çdo ndryshim në strukturën e shoqërive të monitoruara, ku mund të krijohet apo forcohet pozita e dominuese në treg.

Tregu është në procedurë monitorimi në lidhje me zbatimin e kushteve dhe detyrimeve për Tirana Bank si dhe po vlerëson zbatimin e rekomandimeve dhënë Bankës së Shqipërisë për këtë çështje.

Tregu i shërbimit tele-marketing/ tele-shitje

- Grid SHPK me BConnect SHPK

KK, me vendimin nr. 582, datë 17.01.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Grid SHPK nga BConnect SHPK”, vendosi të autorizojë përqendrimin e njoftuar. Ky transaksion u klasifikua si një përqendrim horizontal dhe pjesa e kombinuar e tregut të shërbimeve tele-marketig/tele-shitje (call center) pas përqendrimit arrinte në vlerën 4.71%, duke mos krijuar shqetësime për konkurrencën në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Tregu i shërbimeve në transportin ajror

- ALH Group SHPK me Lufthansa Industry Solutions AS GmbH KK,

KK, me vendimin nr. 598, datë 17.05.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH”, autorizoi përqendrimin e njoftuar. Shoqëria target ofron shërbime në tregun e software-ve dhe është e kontraktuar nga shoqëria blerëse. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

Tregu i hidrokarbureve

- Shoqëria Skysea B.V. me shoqëria Tosk Energji SHA

KK me vendimin nr. 601, datë 21.03.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve nga shoqëria Skysea B.V. tek shoqëria Tosk Energji SHA”, autorizoi përqendrimin e njoftuar. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i furnizimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese. Pala blerëse nuk operonte në tregun shqiptar dhe transaksioni nuk do të sillte asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

Tregu i telefonisë celulare dhe shërbimit të internetit

- Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD

KK, me vendimin nr. 610, datë 10.04.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD”, vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i telefonisë celulare, telefonisë fikse dhe nga analiza u konstatua se transaksioni nuk do të sjellë asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

Me qëllim vlerësimin e efekteve që do të sillte në treg ndryshimi i kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA, KK vendosi të mbajë në monitorim veprimtarinë e shoqërisë Telekom Albania SHA për një periudhë 1 vjeçare nga marrja e vendimit dhe detyrimin e shoqërisë Telekom Albania SHA, për njoftimin paraprakisht pranë Autoritetit të Konkurrencës për të

gjitha ndryshimet e kryera në paketat standarde, oferta promocionale, tarifa standarde që do të hedhë në treg, gjatë periudhës së monitorimit.

Në zbatim të vendimit të KK, shoqëria ka njoftuar për çdo ndryshim të paketave të shërbimeve të ofruara dhe tregu vazhdon të jetë në monitorim.

- Digicom SHPK me Albanian Telecommunications Union SHPK

KK me vendimin Nr. 621, datë 13.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK”, vendosi të autorizojë përqendrimin e njoftuar. Tregu përkatës i produktit në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimeve me pakicë të komunikimeve elektronike, konkretisht tregu me pakicë i shërbimeve të internetit, telefonisë fikse dhe IP TV. Ky transaksion është rasti i një përqendrimi vertikal, ku ndërmarrjet pjesëmarrëse ushtrojnë veprimtari në nivele të ndryshme të zinxhirit të produktit. Pas realizimit të transaksionit pritet të ketë rritje të efektivitetit dhe cilësisë së shërbimit, të mundësisë së transmetimit dhe shpërndarjes të kapaciteteve profesionale nga përdorimi i teknologjisë FTTH në Shqipëri.

Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Tregu i transmetimeve audiovizuale.

- ABC News SHA nga Z. A F dhe Znj. A G

KK, me vendimin nr. 653, datë 17.10.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABC News SHA nga Z. AF dhe Znj. AG”, vendosi të autorizojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë ABC News SHA. Tregu në të cilin ndodhi transaksioni u përcaktua tregu i transmetimeve audiovizive dhe transaksioni nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Tregu i grurit dhe miellit

- Atlas Mills SHPK / Besniku SHPK

KK, me vendimin nr. 622, datë 13.05. “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK”, vendosi autorizimin e transaksionit të njoftuar. Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i importit të grurit, tregu i importit të miellit dhe tregu i përpunimit dhe tregtimit të miellit. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Ai nuk do të sjellë ndryshime domethënëse në tregun shqiptar, pasi pjesa e kombinuar e tregut pas përqendrimit nuk krijonte shqetësime për konkurrencën në treg.

2.2.2 Transaksione në tregun e jashtëm

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 9121/2003, objekt i vlerësimit të përqendrimit janë rastet, të cilat ndodhin në tregun e jashtëm, por që realizojnë të ardhura në tregun shqiptar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. KK, për vitin 2019, ka autorizuar 16 raste të tilla, me anë të vendimeve të renditura më poshtë:

1. Vendim nr. 581, datë 17.01.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.” Transaksioni ndodh në tregun e shërbime kablllore ose direkt në shtëpi nëpërmjet transmetimit satelitor, akses në internet, telefoni fikse ose celulare për abonentët në rajonin e ish-Jugosllavisë dhe nuk sjell asnjë ndryshim në tregun shqiptar.
2. Vendim nr. 590, datë 31.01.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. nga shoqëria CK Holdings Co.,LTD.” Transaksioni prek tregun e furnizimit me shumicë të pjesëve të këmbimit për automjetet e lehta dhe nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në Shqipëri.
3. Vendim nr. 591, datë 31.01.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët të tre shoqërive të reja (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga LG Electronics Inc.dhe Lufthansa Technik AG”. Shoqëria e re do të operojë në tregun e shërbimeve për udhëtarët gjatë transportit ajror dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.
4. Vendim nr. 596, datë 19.02.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A”. Transaksioni ndodhi në tregun e menaxhimit të sistemeve informatikë dhe software-ve. Transaksioni u klasifikua si konglomerat i cili nuk krijon mbivendosje në tregjet e prekura dhe nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.
5. Vendim nr. 606, datë 01.04.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.” Ky transaksion prek tregun ndërkombëtar të shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore dhe nuk ndikon në tregun e brendshëm.
6. Vendim nr. 614, datë 02.05.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies Ltd dhe Champion Motors Ltd”. Treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i ofrimit të shërbimit të transportit privat nëpërmjet automjeteve vet-drejtoese. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në tregun e brendshëm.
7. Vendim nr. 615, datë 02.05.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft”. Transaksioni prekte tregun financiar, por pa krijuar efekte në tregun e brendshëm.

8. Vendim nr. 616, datë 02.05.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V.”. Shoqëria e re do të realizojë ofrimin e automatizimit të integruar digjital dhe zgjidhjeve informative për klientët në industrinë globale të Naftës dhe Gazit Natyror. Transaksioni nuk do të sjellë asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.
9. Vendim nr. 619, datë 09.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.” Transaksioni do të prekë tregun e shitjes së automjeteve dhe pjesëve të këmbimit dhe nuk do të sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.
10. Vendim nr. 624, datë 31.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company”. Transaksioni ndodh në tregun e hidrokarbureve por pa ndikuar në strukturën e tregut në Shqipëri
11. Vendim nr. 625, datë 31.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve të shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Ealldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga shoqëria Mol Germany GmbH”. Transaksioni ndodh në disa tregje të tregtimit me shumicë dhe pakicë dhe për këto arsye u la i hapur. Transaksionet nuk sillnin efekte në tregun e brendshëm.
12. Vendim nr. 631, datë 20.06.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ProQuest Holdings LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC”. Transaksioni prek tregun e transmetimeve televizive por pa efekte në tregun e brendshëm.
13. Vendim nr. 654, datë 23.10.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SKB Banka d.d. Ljubljana nga shoqëria OTP Bank Nyrt”. Transaksioni realizohet në tregun e shërbimeve bankarë dhe duke qenë se shoqëria target nuk vepron apo realizon të ardhura në Shqipëri, transaksioni i njoftuar nuk do të sillte mbivendosje të aktivitetit të biznesit midis palëve të këtij përqendrimi në Shqipëri dhe si rrjedhojë nuk do të kishte ndryshim të strukturës së tregut.
14. Vendim nr. 663, datë 03.12.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Avon Products, Inc nga shoqëria Natura Cosméticos S.A.” Transaksioni ndodhi në tregun e shitjes më shumicë dhe pakicë të produkteve të bukurisë, pa ndikim në tregun shqiptar.
15. Vendim nr. 664, datë 03.12.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët nga shoqëria Hyundai dhe shoqëria Kia Motors Corporation, mbi shoqërinë Ionity Holding GmbH & Co.KG”. Transaksioni ndodhi në tregun e instalimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së karikimit me bateri të automjeteve elektrike.

16. Vendim nr. 671, datë 24.12.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të tërthortë nga shoqëria EXOR N.V tek GEDI Grupoo Editoriale S.p.A.” . Transaksioni prek tregun e mediave, pa ndikim në tregun shqiptar.

2.3 Tregjet e shërbimit / joprodhuese

2.3.1 Marrëveshjet e ndaluara

Tregu i shërbimeve bankare

Mbështetur mbi gjetjet e konstatuara gjatë procedurës së monitorimit, KK, me vendimin nr. 516, datë 22.05.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo, për të vlerësuar nëse ka elemente të shkeljeve të parashikuar në nenin 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 në tregun e shërbimeve bankare.

Në përfundim të hetimit paraprak, KK konkludoi qëndrueshmëri të pjesëve të tregut lidhur me depozitat dhe kreditë, shkallë e lartë përqendrimi në disa segmente të produkteve, norma shumë të ulta dhe të ngurtësuar të interesave të depozitave, norma të larta të interesit të kredive, *spread* disa herë më i lartë krahasuar me normën e interesit të depozitave, komisione dhe penalitete bankare të larta për ndërrimin e bankës (*switching cost*), komisione të larta për transfertat bankare në monedhë të huaj dhe norma të larta fitimi, të cilat ngrinin dyshimin se mund të kishte kufizim të konkurrencës në tregjet përkatëse në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 592, datë 31.01.2019 vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore 01.01.2016 deri në 31.12.2018.

Procedura hetimore ka përfunduar dhe pritet vendimmarrja e KK pas realizimit të seancave dëgjimore me ndërmarrjet nën hetim dhe institucionet rregullatore të tregut përkatës.

Tregu i shërbimit të ndërmjetësimit në sigurime e jetës dhe jo jetës nga bankat e nivelit të dytë

KK, bazuar në ankesën e një prej shoqërive të sigurimit dhe informacionit të përcjellë nga AMF, me vendimin nr. 526, datë 14.06.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime e jetës dhe jo jetës nga bankat e nivelit të dytë.

Pas analizës së dokumentacionit të depozituar, në përfundim të procedurës hetimore u konkludua se:

- Raiffeisen Bank dhe Banka Alpha nuk kanë lidhur marrëveshje me të gjitha shoqëritë e sigurimit për ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit në sigurimin e pronës nga zjarri dhe dëmtimet dhe sigurimin e jetës së debitorit duke kufizuar mundësinë e zgjedhjes nga konsumatori.

- Banka Credins ka të kufizuar ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit të sigurimit të jetës për shoqëritë e tjera të sigurimit të jetës në treg (Insig Jetë dhe Sigal Life) për shkak të licensës së agjentit. Lidhja aksionare mes bankës dhe shoqërisë së sigurimit Sicred SHA ka influencuar në qëndrimin e bankës si ndërmjetës në sigurime duke i orientuar klientët drejt kësaj shoqërie sigurimi. Banka Credins, pavarësisht se ka marrëveshje me të gjitha shoqëritë e sigurimit të jo jetës, të gjitha primet e ndërmjetësuar prej saj janë të siguruar pranë shoqërisë Ansig SHA.
- Banka Kombëtare Tregtare realizon ndërmjetësimin për produktin e sigurimit nga zjarri dhe dëmtimet e pronës duke mos qenë e licensuar për këtë veprimtari.
- Llogaritja e vlerës së primit realizohet mbi bazën e një koeficienti, i cili ndryshon shumë pak nga njëra shoqëri në tjetrën. Shoqëritë e sigurimit nuk kanë një metodë të llogaritjes së primit të sigurimit në përputhje me nenit 87 dhe 88 të Ligjit Nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
- Koeficientet e brokerimit variojnë nga 20% - 62.5% e primeve të nënshkruara dhe nëse i krahasojmë me komisionet e brokerimit të evidentuara në procedurat e mëparshme në tregun e sigurimeve për produktet e TPL apo kartonit jeshil (të cilat variojnë nga 5%-10%), këto komisione janë shumë të larta.
- Mungesa e një metodologjie të llogaritjes së primit të sigurimit (çmimit të policës) e bën të pajustifikueshme ekonomikisht aplikimin e komisioneve të tilla, ndërkohë që risku i sigurimit mbartet totalisht nga shoqëritë e sigurimit.

Në përfundim, u konkludua se nuk u gjetën elementë të një marrëveshje të ndaluar në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 dhe KK, me vendimin nr. 585, datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg nga bankat e nivelit të dytë.

1. Për mirëfunksionimin e tregut, KK vendosi detyrime për bankat e nivelit të dytë si më poshtë:
 - a) Raiffeisen Bank - duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit për shoqëritë e sigurimit të jo jetës, pa kufizuar mundësinë e zgjedhjes së klientëve.
 - b) Alpha Bank - duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit për shoqëritë e sigurimit të jetës dhe jo jetës, pa kufizuar mundësinë e zgjedhjes së klientëve.
 - c) Bankës Kombëtare Tregtare - duhet të aplikojë pranë AMF për licencimin si ndërmjetës në sigurimin e jo jetës, për produktin e sigurimit të pronës nga zjarri dhe dëmet e natyrës.
 - d) Banka Credins - duhet të aplikojë për licensimin si broker për shërbimin e ndërmjetësimit në sigurimin e jetës dhe të orientojë klientët drejt të gjitha shoqërive të sigurimit të jetës dhe jo jetës.
2. T’i rekomandojë AMF:
 - a) Të marrë masa që bankat e nivelit të dytë, të cilat ofrojnë shërbimin e ndërmjetësimit në sigurimeve për klientët e tyre, të pajisen me licensat përkatëse të ndërmjetësimit në sigurime.

- b) Të përcaktojë metodologjinë për përlllogaritjen e primit të sigurimit të pronës dhe jetës nga shoqëritë e sigurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të kërkojë nga shoqëritë e sigurimit orientimin e primeve të sigurimit drejt kostos.
3. AMF brenda 6 muajve nga marrja e këtij vendimi duhet të informojë AK mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në pikën 1 dhe 2 të vendimit.
4. Tregu i ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë do të monitorohet për një periudhë 1 vjeçare nga marrja e vendimit.

Në zbatim të pikës 2 të vendimit të KK, AMF, nëpërmjet korrespondencës shkresore, kërkoj rishikimin e vendimit të KK. Pas vlerësimit të argumenteve të ngritura nga AMF, KK me vendimin nr. 605 datë 21.03.2019 “Mbi mospranimin e kërkesës së AMF për rishikimin e vendimit të KK nr. 585, datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”, vendosi detyrimin e AMF për zbatimin e rekomandimeve të dhëna me vendimit të KK nr. 585 datë 21.01.2019.

Në vazhdim të procesit të zbatimit të rekomandimeve dhe mbështetur në korrespondencën shkresore me AMF, konstatohet se, në lidhje me pikën 2/a të vendimit, AMF po bashkëpunon me BSH lidhur me licensimin e bankave që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e brokerimit. AMF ka kryer inspektime pranë shoqërive të sigurimit në lidhje me marrëveshjet që këto të fundit kanë me bankat e nivelit të dytë, si ndërmjetës në sigurime, dhe ka marrë disa vendime për problematikat e konstatuara.

Me rekomandimin e dhënë me pikën 2/b në lidhje me përcaktimin e metodologjisë për përlllogaritjen e primit të sigurimit të pronës dhe jetës nga shoqëritë e sigurimit, AMF shprehet se primi i riskut duhet të lihet në diskrecionin e shoqërive të sigurimit. Mungesa e kësaj metodologjie, e bën të pamundur vlerësimin e sjelljes së bankave apo kompanive të sigurimit dhe analizën e vlerës së “primit të drejtë”.

Tregu i ofrimit të shërbimeve stomatologjike

KK me vendimin nr. 586, datë 28.01.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike” vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrembërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003.

KK me vendimin nr. 587, datë 28.01.2019 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike” ka vendosur marrjen e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike ndaj Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, duke pezulluar menjëherë zbatimin e Vendimit të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut, nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik”, si dhe detyrimin për të depozituar të gjithë praktikën e ndjekur deri në marrjen e këtij vendimi, për të kryer vlerësimin ligjor të tij, bazuar në nenin 4 dhe 69 të ligjit nr. 9121/2003.

AK gjatë procesit hetimor, bashkëpunoi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e vendimit të mësipërm të KK lidhur me masat e përkohshme si dhe shfuqizimin e aktit të Urdhrit të Stomatologut, procedurë e cila po ndiqej në gjykatë me kërkesë të ministrisë.

AK u vu në dijeni nga Urdhri i Stomatologut për zbatimin e vendimit nr. 587, datë 28.01.2019.

KK me vendimin nr. 599, datë 15.03.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike dhe dhënien e disa rekomandimeve” ka vendosur t’i rekomandojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që:

- i. në respektim të nenit 69 dhe 70 të ligjit, të kërkojnë vlerësimin e AK për çdo projekt akt normativ i cili mund të sjellë kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; që synon vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; apo projekt akte normative të cilat imponojnë praktika të njëjta në çmime dhe kushte të shitjes;
- ii. të kërkojë paraprakisht mendimin e AK në rastet kur parashikohen të përcaktohen metodologji të përcaktimit të tarifave apo rishikime të tarifave në shërbimin stomatologjik;
- iii. tarifat që i ofrohen konsumatorëve në shërbimin stomatologjik duhet të jenë të orientuara drejt kostos.

Gjithashtu i ka rekomanduar Urdhrit të Stomatologut që në rastet e marrjes së vendimeve nga organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut, në lidhje me aspekte të ndryshme, të cilat prekin konkurrencën në treg, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, të respektohen dispozitat e ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

2.3.2 Abuzimi me pozitën dominuese

Tregu i veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit

KK me vendimin nr. 564, datë 25.10.2018 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”. Në përfundim të hetimit paraprak nga analiza e sjelljes së FSHF në tregjet përkatëse, KK konkludoi se: shitja e të drejtës audiovizive tek një operator i vetëm për një periudhë të gjatë 7 vjet, duke përfshirë në një paketë të vetme të gjitha të drejtat ekskluzive, duke u bërë përjashtuese për operatorët e tjerë, çmime të larta të shitjes së biletave krahasuar me rajonin, mund të kufizojnë konkurrencën në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Pas përfundimit të hetimit paraprak KK me vendimin nr. 607, datë 01.04.2019 vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore 01.01.2015 deri në 31.12.2018. Në përfundim të hetimit, nga analiza e konkurrencës, KK konstatoi se FSHF në tregjet përkatëse ka abuzuar me pozitën dominuese dhe në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, FSHF është ftuar për një seancë dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga KK, seancë e cila u zhvillua gjatë muajit dhjetor 2019.

Nga ana e FSHF është kërkuar kohë që ajo të shprehet në lidhje me gjetjet e raportit të hetimit. KK i ka kërkuar FSHF që të marrë angazhime për të rregulluar këtë treg. KK është në procedurë për marrjen e vendimit gjatë vitit 2020.

Tregu i shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës

KK me vendimin nr. 690, datë 10.04.2019 vendosi të miratojë “Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”, për periudhën kohore 1 janar 2018 - 31 mars 2019. Në përfundim të hetimit, KK me vendimin nr. 667, datë 24.12.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në Tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës dhe dhënien e disa rekomandimeve”, vendosi si më poshtë vijon:

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave: a. Të rishikojë dhe përditësojë Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave), nr. 1726/3, datë 21.04.2008 “Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi” dhe unifikimin e të gjitha akteve që dalin në zbatim të këtij udhëzimi.
2. T’i rekomandojë Bashkisë Tiranë, Respektimin e hierarkisë së akteve normative, pas rishikimit dhe përditësimit të udhëzimit nga MIE dhe MF, duke qenë se Këshilli Bashkiak përcakton nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave.; b. të kryejë verifikimin e subjekteve transportuese të licensuar në shërbimin taksi, duke bërë transparente në faqen zyrtare listën e të licensuarve dhe të regjistruarve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
3. T’i rekomandojë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) të kryejë plumbosjen e taksimetrit sipas tarifës së përcaktuar nga Vendimi i Këshillit Bashkiak për të gjithë ndërmarrjet e licensuara që operojnë në tregun e taksive të shoqëruar me numrin e serisë për çdo të licensuar dhe verifikimin e tyre periodik (brenda vitit).

Tregu i shërbimit të ngarkim shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to në terminalin e kontejnerëve Durrës”

Nga vlerësimi i një ankese të paraqitur kundrejt Koncesionarit të Terminalit të Konteinerëve Durrës “Durrës Container Terminal” SHA (DCT SHA) lidhur me faturimin e padrejtë të shërbimit të zbrazjes dhe mbushjes së konteinerëve nga Koncesionari, KK me vendimin nr. 627, datë 13.06.2019 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to në terminalin e kontejnerëve Durrës”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në këtë treg për periudhën kohore nga 01.01.2018

deri më 30.05.2019.

Në përfundim të hetimit paraprak KK konkludoi se: sjellja e ndërmarrjes koncesionare DCT SHA duke ofruar shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, kundrejt një tarife shtesë të vetëpërcaktuar në mënyrë të padrejtë dhe të pa miratuar, mund të përbëjë një abuzim me pozitën dominuese, që zotëron ky koncesionar, në ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se mund të jemi para shkeljes së nenit 9, pika 2, germa (a), të ligjit nr. 9121/2003.

KK me vendimin nr. 649, datë 03.10.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes DCT SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontejnerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes DCT SHA, për periudhën kohore nga 01.01.2018 deri në 30.09.2019.

KK me vendimin nr. 650, datë 03.10.2019, “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës ndaj ndërmarrjes DCT SHA”, vendosi marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes DCT SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontejnerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, si vijon:

- (a) Ndërmarrja DCT SHA duhet të ndalojë aplikimin e tarifave të padrejta për ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës;
- (b) Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore;
- (c) Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrja DCT SHA ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003;
- (d) Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, KK vendos gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, deri sa ndërmarrja DCT SHA të veprojë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa b) të ligjit nr. 9121/2003.

Procedura hetimore ka përfunduar dhe pritet vendimmarrja e KK, lidhur me sjelljen e ndërmarrjes DCT SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontejnerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, për periudhën kohore nga 01.01.2018 deri në 30.09.2019.

2.4 Tregjet prodhuese

2.4.1 Marrëveshjet e ndaluara

Tregu i importit të grurit dhe prodhimit të miellit

KK, me vendimin nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”, ka vendosur hapjen e hetimit paraprak në këtë treg. Gjate procedurës hetimore lindi nevoja për hetime të mëtejshme, prova dhe të dhëna shtesë nga ndërmarrjet prodhuese dhe importuese.

KK me vendimin nr. 612, datë 19.04.2019 “Për një ndryshim në vendimin e KK nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit” vendosi zgjatjen e periudhës hetimore për administrimin e të dhënave për periudhën shtator 2018-mars 2019 për importin e grurit dhe të miellit. Nga hetimi paraprak rezultoi se ndërmarrjet importuese të grurit dhe prodhuesve të miellit janë të integruara vertikalisht; qëndrueshmëria e pjesëve të tregut gjatë periudhës hetimore mundëson ndërmarrjet për t’u bërë faktor përcaktues i ofertës së grurit dhe miellit, duke përjashtuar ndërmarrjet e tjera jo të integruara; sjellja e ndërmarrjeve në lidhje me çmimin e shitjes së produktit miell nuk paraqet trendin e çmimit CIF si dhe trendi i ndryshimit të këtij çmimi paraqitet i njëjtë për të gjitha ndërmarrjet.

KK me vendimin nr. 643, datë 25.07.2019 vendosi “Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas”, pasi mund të ketë elementë të cilat mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës apo sjellje të bashkërenduar referuar nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 nga ndërmarrjet që zënë peshën kryesore në treg, “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas”. Ky hetim do të përfundojë procedurat gjatë vitit 2020.

2.4.2 Abuzimi me pozitën dominuese

Tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto

KK me vendimin nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto” (të ndryshuar), vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, për periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 30 nëntor 2018.

KK me vendimin nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”, vendosi marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD, vendim i cili i është njoftuar ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD, nëpërmjet shkresës nr. 607/12 prot, datë 20.12.2018.

Lidhur me zbatimin e vendimit të mësipërm nga ana e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD, KK është shprehur me vendimin nr. 603, datë 21.03.2019 “Mbi zbatimin e vendimit të

KK nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”.

KK me vendimin nr. 652, datë 10.10.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, për periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 31 tetor 2019.

Gjatë periudhës së hetimit të thelluar është kërkuar informacion nga ndërmarrja nën hetim “Bankers Petroleum Albania” LTD, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe shoqëria Albpetrol SHA, si dhe është kryer inspektim pranë ndërmarrjes nën hetim “Bankers Petroleum Albania” LTD. Ky hetim do të përfundojë procedurat gjatë vitit 2020.

Tregu i depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS) ka paraqitur Shkresën më datë 19.10.2018, protokolluar pranë AK me nr. 601 prot., me objekt “Njoftim për një sjellje të mundshme anti-konkurruese dhe kërkesë për hetim” (“*Notification of potential anti-competitive conduct and request for investigation*”), në lidhje me dy procedura tenderuese që KESH ka zhvilluar referuar: “Kontratës së depozitimit” lidhur midis KESH SHA dhe shoqërisë EFT AG dhe “Kontratës së devijimit” lidhur midis KESH SHA dhe shoqërisë GSA SHPK.

KK me vendimin nr. 588, datë 28.01. 2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrebbërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003.

KK me vendimin nr. 644, datë 31.07.2019 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të ligjit nr.9121/2003, KK ka vendosur:

1. Konstatimin e shkeljes së rregullave të konkurrencës që rrjedhin nga pozita dominuese e KESH, në drejtim të procedurave për lidhjen dhe zbatimin e:
 - c. Kontratës së devijimit të energjisë elektrike mes shoqërive KESH SHA dhe GSA SHPK.
 - d. Kontratës së depozitimit të energjisë elektrike mes shoqërive KESH SHA me EFT AG.
2. Dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA:
 - a. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA në zbatim të vendimin nr. 93/2019 të ERE të ndërpresë vazhdimësinë e këtyre dy kontratave.
 - b. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA të njoftojë Sekretariatit të Energjisë në Vjenë për ecurinë e zbatimit të vendimit nr. 93/2019 të ERE.
 - c. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës për ecurinë e zbatimit të vendimit nr. 93/2019 të ERE.
 - d. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA, si operator me pozite dominuese, për çdo kontratë të ardhshme, e cila vendos të drejta të veçanta ose ekskluzive, për

ndërmarrje (kompani) ose për produkte te caktuara, të kërkojë një vlerësim paraprak nga KK.

Ky treg është në monitorim deri në muajin korrik 2020.

2.4.3 Hetime të përgjithshme

Tregu i shërbimeve spitalore

KK, me vendimin nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”, vendosi fillimin e procedurës së vlerësimit të konkurrencës në shërbimin spitalor i cili përfshin shërbimin spitalor publik dhe shërbimin privat.

Gjatë procedurës hetimore u kërkuar informacion nga institucionet spitalore publike dhe private, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor. Analiza hetimore kishte për qëllim të vlerësonte konkurrencën në dy shërbimet sipas indikatorëve të cilësisë/profesionalizmit diagnostifikues dhe performancës financiare.

Mbi të dhënat e administruara dhe në përfundim të analizave të realizuar, raporti u paraqit pranë KK, i cili konkludoi se vlerësimi i tregut të shërbimit spitalor kërkon analiza shtesë dhe me vendimin nr. 669, datë 24.12.2019 “Për vijimin e hetimit të hapur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar”, Komisioni vendosi vijimin e hetimit në këtë treg.

Për të realizuar një vlerësim më të thelluar të tregut të shërbimeve spitalore, kërkohet administrim i të dhënave shtesë nga ofruesit e shërbimit dhe shtrirja e analizës për një periudhë më afatgjatë. Vijimi i hetimit do të fokusohet në vlerësimin e legjislacionit që vepron në shërbimin spitalor privat dhe publik, duke përfshirë dhe të drejtat e veçanta dhënë nëpërmjet kontratave koncesionare apo PPP-ve; vlerësimin e politikave sociale dhe përmirësimin e nivelit profesional të stafit mjekësor; politikave të vendosjes së çmimeve të shërbimeve /ekzaminimeve dhe investimet në pajisje dhe teknologjinë; krahasimin e sistemit spitalor në Shqipëri me modelet e vendeve të rajonit dhe më tej si dhe bashkëpunimin mes institucioneve të shërbimit spitalor me shoqëritë e sigurimit dhe skemat e rimbursimit.

Sektori i arsimit të lartë

KK me vendimin nr. 573, datë 26.11.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin e arsimit të lartë me qëllim kryerjen e një analize të plotë në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar, si nga IAL-të publike dhe ato private, si dhe respektimin e rregullave të konkurrencës në këtë treg.

Gjatë procedurës së hetimit të përgjithshëm është kërkuar informacion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si dhe nga Universitetet publike dhe private në lidhje me burimet e të ardhurave të IAL-ve; rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave; cila është pjesa e buxhetit për mësimin, kërkimin, zhvillimin e personelit, pagat; metodologjinë e llogaritjes së kostos së

studimeve, tarifës së studimit; koston së programit të studimit; politikën dhe procedurën e dhënies së bursave; politikën e pagave të IAL-ve dhe strukturën e të punësuarve, etj.

KK me vendimin nr. 672, datë 24.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”, zgjati me 6 muaj afatin e hetimit, në kushtet e volumit të madh të informacioneve për t’u përpunuar dhe volumit të të dhënave ekonomike si rrjedhojë e gamës së gjerë të programeve që ofrojnë IAL-të publike dhe private, me qëllim vlerësimin dhe kryerjen e një analize të plotë të konkurrencës në sektorin e Arsimit të Lartë.

Sektori i profesioneve të lira

KK me vendimin nr. 668, datë 24.12.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e profesionit të avokatit, noterit dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme”, pas kryerjes së procedurave të hetimit të thelluar në këtë treg ka dhënë rekomandimet e mëposhtme:

- Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë lidhur me profesionin e avokatit:
 1. Plotësimin e kuadrit nënligjor përkatës në fushën e avokatisë bazuar në dispozitat e ligjit 55/ 2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”;
 2. Dërgimin për mendim dhe vlerësim të draft-akteve nënligjore të hartuara nga organet përkatëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, të shoqëruara me relacionet përkatëse dhe në rastet e hartimit të akteve nënligjore që përcaktojnë tarifa, ky draft akt të jetë i shoqëruar edhe me metodologji të përllogaritjes së tarifave, me qëllim vlerësimin e tyre konform ligjit nr. 9121/2003.
 3. Respektimin e dispozitave ligjore duke ofruar transparencë lidhur me shërbimet dhe çmimet që ofron profesioni i avokatit. Mundësi aksesimi nga të gjithë konsumatorët i informacionit të nevojshëm.
 4. Kryerja e amendimeve të nevojshme në Statutin e Dhomës së Avokatisë dhe Kodin e Etikës;
 5. Faqja zyrtare e ëeb e DHKA të pasqyrojë gjithë informacionin e nevojshëm përfshirë edhe informacionet lidhur me trajnimet që duhet të ofrojë dhoma.
- Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterëve lidhur me profesionin e noterit:
 1. Plotësimin e kuadrit nënligjor përkatës në fushën e noterisë bazuar në dispozitat e ligjit të 110/ 2018 “Për Noterinë”.
 2. Dërgimin për mendim dhe vlerësim të draft-akteve nënligjore të hartuara nga organet përkatëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, të shoqëruara me relacionet përkatëse dhe në rastet e hartimit të akteve nënligjore që përcaktojnë tarifa; ky draft akt të jetë i shoqëruar edhe me metodologji të përllogaritjes së tarifave, me qëllim vlerësimin e tyre konform ligjit 9121/2003.
 3. DHKN duhet t’u ofrojë asistencën e duhur noterëve lidhur me trajnime të vazhdueshme dhe kualifikime;
 4. Kur të draftohet urdhri i ri “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”, të merret në konsideratë

mundësia lidhur me unifikimin e përmasave të tabelave, llojit të shkrimit, vetë ngjyrës së tabelës duke ofruar të njëjtin perceptim për konsumatorët dhe pa manipuluar zgjedhjen konsumatore .

5. Përfshirja e AK për evidentimin e problematikave të ndryshme që mund të ekzistojnë dhe prekin fushën e konkurrencës. Organizimi dhe pjesëmarrja në seminare/konferenca lidhur me konkurrencën në tregun e ofrimit të shërbimeve të profesioneve të lira.
- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Shoqatës së Vlerësuesve të Pasurive:
 1. Rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues duke parashikuar dispozita ligjore për organizimin dhe funksionimin e SVP.
 2. Në rast rishikimi të Udhëzimit nr. 4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve të ekspertëve në gjykatë”, të merret mendimi i Autoritetit të Konkurrencës para miratimit të ndryshimeve. Përcaktimi i pagesave dhe tarifave të ekspertëve në çdo rast duhet të jenë të orientuara drejt kostove të ofrimit të shërbimit, të shoqëruara me metodologji të përlllogaritjes së tyre dhe relacione shpjeguese.
 3. Dërgimi për mendim pranë AK të çdo projekt akti i cili synon të përcaktojë tarifa, të vendosë barriera për hyrjen në treg, të shoqëruara me relacionet dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.
 4. Kurset dhe provimet e kursit të formimit të vazhduar të jenë cilësore për të prodhuar diploma/certifikata cilësore me standard.
 5. Të hartohen standarde shqiptare të vlerësimit si edhe të ngrihet një organizëm i pavarur me anëtar profesionistë të licencuar për kontrollin dhe monitorimin e standardeve dhe Etikës së ekspertëve.
 6. Në rast rishikimi të VKM nr. 712 datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullore për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”, të shikohet mundësia e heqjes së kufizimeve që pengojnë hyrjen në treg, lehtësimin e kushteve dhe kriterëve për të marrë licencën e VPP duke lehtësuar hyrjen në treg të profesionistëve të rinj.
 7. Të forcohet roli i shoqatës së vlerësuesve, si kusht për rritjen e cilësisë së shërbimeve të vlerësimit, vendosjen e kontakteve me organizata e shoqata të së njëjtës natyrë dhe shkëmbimi i përvojës me ta; hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë ngritjen profesionale.
 - T’i rekomandojë bankave të nivelit të dytë:

Shpërndarja e vlerësimeve duhet të kryhet tek të gjithë vlerësuesit e përzgjedhur. Procesi i përzgjedhjes së vlerësuesve duhet të jetë transparent dhe të zbatohen deri diku parimet e prokurimit publik, ku vlerësuesit të konkurrojnë midis tyre nëpërmjet parimeve të mirënjohura mbi të cilat funksionon dhe rregullohet ky profesion.

KK, me vendimin nr. 660, datë 21.11.2019 ka dhënë disa rekomandime lidhur me procedurat e caktimit të ekspertëve për vlerësimin e dëmeve në sigurime, në procedurat gjyqësore. Autoriteti i Konkurrencës i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë të krijojë administrojë dhe publikojë Regjistrin Elektronik për Ekspertët vlerësues të dëmeve në sigurime dhe brenda 90

ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit të njoftojë edhe Autoritetin e Konkurrencës. Ky rast është shqyrtuar pas depozitimit të një ankese në AK.

Nisur nga një ankesë e paraqitur nga Dhoma e Noterisë Tiranë, në lidhje me ofrimin e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike, AK ka kryer vlerësimin e kësaj ankese duke ndjekur procedurat e nevojshme. KK ka organizuar seancat dëgjimore me përfaqësues të Dhomës së Noterisë Tiranë, të MIE dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor në datën 9 maj 2019.

KK me vendimin nr. 638, datë 18.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve për ofrimin e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike” ka vendosur t’i rekomandojë Ministrisë së Drejtësisë:

- Të rishikojë Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 279, datë 14.06.2012 “Për Miratimin e tarifave të shërbimeve noteriale” i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, duke përcaktuar tarifa noteriale konkurruese, lidhur me ofrimin e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike.
- Tarifat për shërbimet noteriale, të jenë të orientuara drejt kostos dhe të bazuara në një metodologji të përlllogaritjes së tyre.
- Të dërgojë për mendim pranë AK projektaktet nënligjore të cilat kanë të bëjnë me përcaktimet e tarifave apo vendosjen e kufizimeve të ndryshme, në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 9121/2003.

PJESA E TRETË

AUTORITETI I KONKURRENCËS PËRBALLË PROCESEVE GJYQËSORE

Gjatë vitit 2019 proceset gjyqësore të AK kanë vijuar si më poshtë:

3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (2019)

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë përgjatë 2019 është shqyrtuar 1 (një) çështje:

Çështja Gjyqësore me: paditës: shoqëria “Conad”, të paditur AK lidhur me Vendimin nr. 560, datë 15.10.2018 të KK “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve”. Gjykata Administrative e Shkallës së parë e rrëzoi kërkesë padinë e shoqërisë “Conad”.

3.2 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Apelit (2019)

Në Gjykatën Administrative të Apelit, është gjykuar 1 (një) çështje:

Gjykata Administrative e Apelit, më datë 18.06.2019, në dhomë këshillimi, vendosi rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë nga ana e shoqërisë “EKMA Albania” SHPK, lidhur me vendimin nr. 572, datë 22.11.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “Ekma Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës” dhe pranimin e Ankimit të Autoritetit të Konkurrencës, duke i krijuar kështu mundësinë për ekzekutimin e gjobës dhe masave rregulluese.

Mbeten për t’u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit 8 (tetë) çështje gjyqësore, për të cilat jemi në pritje të caktimit të datave respektive.

PJESA E KATËRT

ROLI I AUTORITETIT TË KONKURRENCËS NË FORMULIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE TË TJERA - ADVOKACIA E KONKURRENCËS

4.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt akteve normative

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2019 ka vlerësuar projekt-aktet normative:

4 (katër) projektligje:

- Projektligji “Për Sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i cili përcakton dispozita lidhur me themelimin, licencimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, depozitarëve dhe shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.
- Projektligji ‘Për shërbimet e pagesave’, i cili rregullon shërbimet e pagesave, krijimin, licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave, si dhe të drejtat dhe detyrimet përkatëse të përdoruesve dhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave në lidhje me ofrimin e shërbimit të pagesave.
- Projektligji “Për tregjet e kapitalit”, i cili rregullon tregjet e kapitalit duke përcaktuar mënyrën dhe kushtet për ofrimin, blerjen dhe shitjen e instrumenteve financiare, përcakton procedurat për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të instrumenteve financiare për të garantuar efikasitetin dhe transparencën e tyre.
- Projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili përcaktonte rregullat dhe procedurat për këtë treg.

2 (dy) projektakte normative:

- Projekt-rregullore “Për dhënien e licencave të transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale”, e cila përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave të transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale.
- Projekt-rregullore “Për Kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”, e cila përcakton kriteret, rregullat dhe procedurat e dhënies së licencës së shërbimit audioviziv.

22 (njëzetë e dy) projekt akte normative në tregun e energjisë:

ERE, gjatë vitit 2019, ka dërguar për opinion pranë AK, projekt aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe ligjit nr. 138/213 “Për burimet e rinovueshme”.

17 (shtatëmbëdhjetë) projekt akte normative në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave:

ERRU gjatë vitit 2019 ka sjellë për opinion mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për Ujësjetellës Kanalizime Gjirokastër SHA; Poliçan SHA; Delvinë SHA; Tropojë SHA; Lushnje SHA; Malësi e Madhe SHA; Berat-Kuçovë SHA; Himarë SHA; Vlorë SHA; Krujë SHA; Berat - Kuçovë SHA; Malësi e Madhe SHA; Ujësjetellës Kanalizime Lushnje SHA; Tropojë SHA; Delvinë SHA; Poliçan SHA; Gjirokastër SHA.

4.2 Advokacia e Konkurrencës

Gjatë vitit 2019 në funksion të advokacisë, AK ka realizuar një sërë aktiviteteve si më poshtë:

AK, gjatë vitit 2019, si përfitues i **Projektit të BERZH** “Asistencë teknike për AK, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia”, në zbatim të komponentit 1. të projektit “Strategjia për Advokacinë e Konkurrencës” ka nisur hartimin e Strategjisë së Advokacisë për AK.

AK, nëpërmjet projektit të Bashkimit European, IPA 2015, **IPA Twinning** “Forcimi kapaciteteve për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”, projekt binjakëzimi me autoritetin Spanjoll të Konkurrencës (CNMC), në zbatim të komponentit 3. “Roli i AK për të bashkëpunuar me palë të ndryshme interesi”, do të zhvillojë seminare dhe takime me entet rregullatore, aktorë të ndryshëm të tregut, në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

4.2.1 Konferenca dhe Tryezat e Rrumbullakëta

Në planin vjetor dhe buxhetor të AK, çdo vit parashikohen aktivitete për sensibilizimin e publikut për rolin e Autoritetit në garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si dhe njohjen më të saktë me fushën e veprimtarisë së Autoritetit.

Në periudhën tetor-dhjetor 2019 u realizuan këto aktivitete:

3. Konferencë me rastin e 15 vjetorit të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, me titull “Konkurrenca dhe Sipërmarrjet” në 14 nëntor 2019. Në këtë aktivitet ishin të ftuar dhe mbajtën fjalën emra të politikës si Nënkryetarja e Kuvendit të RSH, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si dhe Sekretari i Parë i Seksionit për Zhvillim Ekonomik dhe Social i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Në të morën pjesë edhe përfaqësues të enteve rregullatore ose organizatave, si vendase ashtu edhe të huaja si Enti Rregullator i Ujit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë, dhe Fondacioni Ibero-Amerikan dhe Ndërkombëtar për Administratën dhe Punët Publike. Me anë të këtij aktiviteti u krye gjithashtu lançimi i projektit të binjakëzimit IPA me titull “Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Autoritetit të Konkurrencës për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”
4. Tryezë e rrumbullakët në qytetin e Vlorës, në 25 nëntor 2019, në Universitetin “Ismael Qemali”, me temë: “Të njohim konkurrencën dhe sfidat e saj”
5. Tryezë e rrumbullakët në qytetin e Shkodrës, në datë 11.11.2019, në Universitetin “Luigj Gurakuqi, me temë: “Të njohim konkurrencën dhe sfidat e saj”

PJESA E PESTË

INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

5.1 Kontributi në kuadrin e Integrimit Evropian

Në zbatim të Planit Kombëtar Për Integrimin European 2019-2022, AK ka vijuar procesin e përafrimit të legjislacionit me direktivat europiane në fushën e konkurrencës si më poshtë:

KK me vendimin nr. 633, datë 26.06.2019 miratoi udhëzuesin nr. 3 datë 26.06.2019 “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e ligjit nr. 9121/2003”.⁵

AK si institucion lider i kapitullit 8 të MSA “Politika e konkurrencës”, gjatë procesit të *pre-screening* i cili u realizua gjatë takimit shpjegues “*Explanatory Meeting*” në Komisionin European në datat 4-6 nëntor 2019, ku përfaqësues të DG Competition paraqitën kuadrin ligjor european në fushën e konkurrencës. Nga pala shqiptare ishin përfaqësues anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian për kapitullin 8 “Politika e konkurrencës”, ku bëjnë pjesë konkurrenca, ndihma shtetërore dhe liberalizimi.

Gjithashtu, AK në vijim të fillimit të procesit të përgatitjes për Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022, të njoftuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka iniciuar punën në bashkëpunim me institucionet e tjera pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian pjesë e kapitullit 8 “Politika e konkurrencës” me qëllim evidentimin e akteve relevante për t’u përafruar në periudhën 2020-2022 në fushën e konkurrencës si dhe duke marrë në konsideratë edhe fushat e ekspertizës së institucioneve të tjera pjesë e GNPIE.

5.2 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Gjatë veprimtarisë së vitit 2019, AK ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjerë, duke marrë pjesë në aktivitetet si më poshtë:

Memorandume Mirëkuptimi

- Në datat 10-11 qershor 2019 u organizua takimi me Autoritetin Kroat të Konkurrencës, ku u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet AK dhe këtij Autoriteti homolog, me qëllim promovimin e bashkëpunimit në fushën e politikës së konkurrencës dhe zbatimit të ligjit të konkurrencës së palëve, të krijojë kushte të favorshme për avancimin e marrëdhënieve bilaterale dhe bashkëpunimit rajonal, bazuar në parimet e barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë, duke e cilësuar rolin e konkurrencës si një mekanizëm efektiv për një ekonomi tregu të zhvilluar. Gjithashtu ky memorandum bashkëpunimi synon shkëmbimin e informacionit mbi zhvillimet legjislative; shkëmbimin e përvojave në fushën e hetimeve, në lidhje me shkeljen e

⁵ Në përputhje me Direktivën 2014/104/EU e Parla mentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 nëntor 2014 “Mbi disa rregulla që rregullojnë veprimet për dëmet e ligjit kombëtar për shkelje të dispozitave të ligjit të konkurrencës të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian” (32014L0104/ OJ L 349, 5.12.2014).

rregullave të konkurrencës; shkëmbimin e përvojave midis autoriteteve të konkurrencës dhe enteve kombëtare rregullatorë.

- Në kuadër të “Memorandumit të Mirëkuptimit” midis Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës dhe Autoritetit Maltez të Konkurrencës dhe të Çështjeve të Konsumatorit, në datat 26 – 27 shtator, përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës zhvilluan një vizitë në Maltë. Në takimin me Drejtorinë e Konkurrencës, përfaqësuesit e Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës u njohën nga afër me eksperiencën e një vendi anëtar të BE në lidhje me zbatimin e ligjit të konkurrencës, bashkëpunimin midis vendeve anëtare në kuadër të Rrjetit Evropian të Konkurrencës (ECN), harmonizimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian dhe veçanërisht me Direktivën ECN+.

Aktivitete:

Gjatë vitit 2019, AK ka marrë pjesë në eventet e mëposhtme:

- AK mori pjesë në takimin e 18-të të Grupit Ndërqeveritar të Ekspertëve (IGE) për Ligjin dhe Politikën e Konkurrencës të UNCTAD i cili u zhvillua në datat 10-12 korrik 2019, në Gjenevë, Zvicër.
- Në datat 27 shkurt 2019, AK mori pjesë në konferencën e OECD, “Dita e Hapur e Konkurrencës” e cila u zhvillua në Paris, Francë.
- Në datat 5-6 dhjetor 2019, AK mori pjesë në Forumin Global të Konkurrencës në OECD në Paris, ku AK paraqiti kontributin në sesionin “Konkurrenca për tregun”.
- AK mori pjesë në sesionin e 67-të të Takimit Vjetor të Pranverës për Antitrust Law Session në datat 26-29 mars 2019 në Washington DC, SHBA, organizuar nga American Bar Association.

Gjatë vitit 2019, AK vijoi bashkëpunimin me OECD-GVH/RCC nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme që kjo qendër ofron për vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. AK mori pjesë në aktivitetet e mëposhtme:

- Në datat 11-13 mars 2019, AK mori pjesë në seminarin me temë “Kufizimet në shitjet vertikale dhe E-commerce” i cili u zhvillua në Budapest, Hungari.
- Në datat 10-12 shtator 2019, AK mori pjesë në seminarin me temë “Zbatimi i ligjit të Konkurrencës dhe Advokacia në Sektorin Farmaceutik” i cili u zhvillua në Kiev, Ukrainë.
- Në datat 22-24 tetor 2019, AK mori pjesë në seminarin me temë “Masat Rregulluese në Rastet e Konkurrencës” i cili u zhvillua në Budapest, Hungari.
- Në datat 10-12 dhjetor 2019, AK mori pjesë në seminarin me temë “Konkurrenca në Sektorin e Energjisë”, i cili u zhvillua në Budapest, Hungari.
- AK ka marrë pjesë në Forumin e 24-t të Komunitetit e Sekretariatit të Energjisë (ECS) në 28-29 maj 2019, i cili u mbajt në Athinë, Greqi.

- AK vijoi gjithashtu bashkëpunimin me Joint Vienna Institute, ku në datat 25 shkurt - 1 mars 2019 ka marrë pjesë në seminarin me temë “Konkurrueshmëria, Rritja dhe Kriza” i cili u zhvillua në Vjenë.
- AK në bashkëpunim me JICA mori pjesë në trajnimin dy javor i cili u zhvillua në Japoni me temë “Ligji dhe Politika e Konkurrencës – Promovimi i Konkurrencës” në datat 20 korrik - 10 gusht 2019, Tokyo dhe Kobe.

Aktivitete të tjera- marrëdhënie me autoritetet homologe :

- AK mori pjesë në datat 13-15 mars 2019 në Konferencën Ndërkombëtare të 19-të për Konkurrencën, e cila u zhvillua nga Autoriteti Gjerman i Konkurrencës, Bundeskartellamt, në Berlin.
- AK mori pjesë në datën 4 prill 2019 në Konferencën me temë “Konsumatori Evropian dhe Dita e Konkurrencës”, i cili u organizua nga Autoriteti Rumun i Konkurrencës në Bukuresht.
- AK mori pjesë në datën 12 prill 2019 në Konferencën për Ditën e Konkurrencës, i cili u organizua nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës së Serbisë në Beograd.
- AK mori pjesë në datat 14-18 maj 2019 në Forumin Ndërkombëtar për ligjin në Shën Petersburg, i cili u organizua nga Federata Ruse në bashkëpunim me Autoritetin Rus të Konkurrencës.
- AK mori pjesë në datat 11-12 shtator në seminarin e 12 vjetor për konkurrencën në Evropën Lindore, i cili u organizua nga Autoriteti Hungarez i Konkurrencës në Budapest.
- AK, në vijim të bashkëpunimit me Florence Competition Programme, ka marrë pjesë në takimin me temë: “Trendi Antitrust, Mënyra Evropiane”, i cili u zhvillua në datën 25 tetor në Firence, Itali.

PJESA E GJASHTË


ORGANIZIMI I AUTORITETIT

6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës

Për vitin 2019, Autoriteti Konkurrencës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 ka synim forcimin e kapaciteteve dhe përshtatjen me modelin e institucioneve homologe të vendeve të BE-së.

Struktura e miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 128/2018 “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Konkurrencës” ka synuar kryesisht në shtimin e numrit të punonjësve prej tre punonjës në drejtoritë teknike, për të mbuluar aktivitetin në rritje, për gjithë tregjet në territorin e RSH, me qëllim sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive, si në tregjet prodhuese dhe ato të shërbimit. Rritja e numrit të punonjësve do të sigurojë që analizat, studimet, inspektimet dhe gjithë procedurat hetimore do të kryhen më shpejt brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Struktura organizative e AK paraqitet si më poshtë:



6.2 Të ardhura të derdhura në buxhet dhe realizimi i buxhetit të miratuar për AK për vitin 2019

Gjatë vitit 2019, AK ka derdhur në buxhetin e shtetit shumën totale **12,583,318 lekë**, e cila është derdhur si e ardhur nga përqendrimet (njoftim dhe autorizim përqendrimi).





Tabela e shpenzimeve të AK për vitin 2019

Kodi	Emërtimi	Plani (me ndryshime)	Fakti	/
		Lekë		
600	Paga, shpërblime etj.	50,700,000	48,049,000	94.8%
601	Kontribute për Sigurime Shoqërore	8,500,000	7,536,000	88.7%
602	Materiale dhe Shërbime	15,260,000	14,000,000	91.7%
231	Investime	3,500,000	3,448,679	98.5%
Totali		77,960,000	73,033,679	94%

6.3 Rekrutimet


Gjatë vitit 2019, në kuadër të plotësimit të nevojave të drejtorive teknike, janë realizuar 8 procedura rekrutimi me lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil. Të gjitha procedurat janë realizuar konform kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe duke pasur në konsideratë sistemin e karrierës në shërbimin civil. Qëllimi në këto procedura ka qenë dhe do të mbetet pranimi i stafit me integritet profesional dhe eficient.





Gjatë vitit 2019 janë realizuar 32 trajnime jashtë vendit dhe 10 brenda vendit, ku është trajnuar një numër i konsiderueshëm prej 55 punonjësish të institucionit, ku një pjesë e punonjësve rezultojnë të jenë trajnuar më shumë se një herë. Të gjitha trajnimet janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të AK me OECD-GVH/RCC, dhe brenda vendit, nga Shkolla e Administratës Publike si dhe nga:

Projekt i Bashkimit European, IPA 2015, **IPA Twinning** “*Forcim kapacitetesh për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg*” projekt binjakëzimi me autoritetin Spanjoll të Konkurrencës (CNMC), sipas komponentit 2. “*Organizimi i trajnimeve dhe vizitave studimore*”, janë duke u zhvilluar trajnime për stafin e AK në lidhje me tema të ndryshme për çështjet e konkurrencës (përkatësisht 6 trajnime dhe është realizuar një vizitë studimore).

Projekt i BERZH “*Asistencë teknike për AK, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia*”, në komponentin 2. “*Forcimi i kapaciteteve administrative të AK*” janë parashikuar gjatë vitit 2020, trajnime për stafin në lidhje me programin STATA dhe analiza ekonometrike, trajnime për legjislacionin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, trajnime të vazhdueshme në fusha të ndryshme të konkurrencës.





PJESA E SHTATË

PRIORITETET E AK PËR VITIN 2020

7.1 Prioritetet e AK për vitin 2020

Për vitin 2020, AK, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9121/2003, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, do të vazhdojë mbikëqyrjen dhe hetimet kryesisht në tregjet me impakt të drejtpërdrejtë në interesat dhe mirëqenien e konsumatorit:

- *tregu i shërbimit të transportit ajror aeroporti TIA;*
- *tregu farmaceutik;*
- *tregu i shërbimit stomatologjik;*
- *tregu i gazit të lëngshëm (GLN);*
- *tregu i Subjekteve Financiare Jo-Bankë.*

si dhe do të vazhdojë monitorimin dhe përfundimin e hetimeve në tregjet e:

- *tregu i telefonisë celulare;*
- *tregu i shërbimit spitalor;*
- *tregu bankar;*
- *sektori i arsimit të lartë;*
- *tregu i veprimtarive ekonomike të FSHF;*
- *tregu i nxjerrjes dhe përpunimit të naftës.*

7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE-së

Gjatë vitit 2020, AK do të:

- Në kuadër të implementimit të projektit IPA Twinning “*Forcimi kapacitetesh për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg*” të realizojë amendimet ligjore (shtesa dhe ndryshime) të ligjit nr. 9121/2003 në përputhje me *acquis* të Bashkimit Evropian, dhe problematikat e dala gjatë zbatimit të ligjit, si dhe rishikimin e kuadrit sekondar ligjor.
- Në kuadër të implementimit të projektit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) “Asistencë teknike për AK, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia”, të hartojë “Strategjinë 5 vjeçare të advokacisë së konkurrencës”.
- Të sigurojë zbatimin e Kornizës së procedurave të AK, (Competition Agency Procedures CAP) në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN).
- Forcojë kapacitetet administrative, nëpërmjet trajnimit të stafit të ri dhe ekzistues me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit, inspektimit, hartimit të raporteve, analizave, si cilësinë e mbrojtës së vendimeve të KK në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

- Vazhdojë të zbatojë PKIE 2019-2022, për vitin 2020, dhe detyrat që rrjedhin nga MSA, si lider i kapitullit të 8-të “Politika e Konkurrencës”, ku do të punojë për përafrimin e akteve të mëposhtme:
 - ✓ Udhëzim i Komisionit Evropian (2002/C 165/03) mbi analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së konsiderueshëm të tregut, në kuadrin rregullator të Komunitetit, për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike. (52002XC0711(02).
 - ✓ Direktiva (EU) 2019/1 “Të fuqizojë autoritetet e konkurrencës së shteteve anëtare të BE-së për të qenë me efektive dhe të sigurojë mirëfunksionimin e tregut të brendshëm” (ECN+), (32019L0001).
- Angazhohet në rritjen e bashkëpunimit me institucione të tjera homologe dhe ente rregullatore, duke nënshkruar me to edhe Memorandume Mirëkuptimi (MOU).

ANEKSE

VENDIMET E AK 2019

1. Vendim nr. 580, datë 17.01.2019, “Mbi përfitim e kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të TIRANA BANK SHA nga PIRAEUS BANK SA tek BALFIN SHPK dhe KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE”.
2. Vendim nr. 581, datë 17.01.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.”
3. Vendim nr. 582, datë 17.01.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Grid SHPK nga BConnect SHPK”.
4. Vendim nr. 583, datë 17.01.2019, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 564, datë 25.10.2018, “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon””
5. Vendim nr. 584, datë 24.01.2019, “Mbi miratimin e Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës””.
6. Vendim nr. 585, datë 24.01.2019, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”
7. Vendim nr. 586, datë 28.01.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike”
8. Vendim nr. 587, datë 28.01.2019, “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike”
9. Vendim nr. 588, datë 28.01.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike”
10. Vendim nr. 589, datë 31.01.2019, “Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019”
11. Vendim nr. 590, datë 31.01.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitim të kontrollit të shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. nga shoqëria CK Holdings Co.,LTD.”
12. Vendim nr. 591, datë 31.01.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët të tre shoqërive të reja (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga LG Electronics Inc.dhe Lufthansa Technik AG”.
13. Vendim nr. 592, datë 31.01.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”
14. Vendim nr. 593, datë 07.02.2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër” SHA”
15. Vendim nr. 594, datë 07.02.2019, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Bankën e Shqipërisë me Vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”.
16. Vendim nr. 595, datë 19.02.2019, “Për mos klasifikimin si përqendrim të njoftimit mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë InfoSoft Business Solutions SHPK.”
17. Vendim nr. 596, datë 19.02.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A”.
18. Vendimin nr. 597, datë 19.02.2019, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”.
19. Vendim nr. 598, datë 15.03.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH”.
20. Vendim nr. 599, datë 15.03.2019, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike dhe dhënien e disa rekomandimeve”.
21. Vendim nr. 600, datë 15.03.2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjiellës Kanalizime Poliçan” SHA”.
22. Vendim nr. 601, datë 21.03.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve nga shoqëria Skysea B.V. tek shoqëria Tosk Energji SHA”.
23. Vendim nr. 602, datë 21.03.2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjiellës Kanalizime Delvinë” SHA”
24. Vendim nr. 603, datë 21.03.2019, “Mbi zbatimin e Vendimit të KK nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”

25. Vendim nr. 604, datë 21.03.2019, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto””
26. Vendim nr. 605, datë 21.03.2019, “Mbi mospranimin e kërkesës së AMF për rishikimin e Vendimit nr. 585, datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”
27. Vendim nr. 606, datë 01.04.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.”
28. Vendim nr. 607, datë 01.04.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit.”
29. Vendim nr. 608, datë 10.04.2019, “Mbi detyrimin për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK”
30. Vendim nr. 609, datë 10.04.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës.”
31. Vendim nr. 610, datë 10.04.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telekom Invest AD”
32. Vendim nr. 611, datë 10.04.2019, “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, I ndryshuar.””
33. Vendim nr. 612, datë 19.04.2019, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”
34. Vendim nr. 613, datë 19.04.2019, “Mospranimi i kërkesës së Bankës së Shqipërisë në lidhje me rekomandimet e dhëna me Vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”
35. Vendim nr. 614, datë 02.05.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies Ltd dhe Champion Motors Ltd”
36. Vendim nr. 615, datë 02.05.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volksëagen Financial Services Aktiengesellschaft”
37. Vendim nr. 616, datë 02.05.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V
38. Vendim nr. 617, datë 09.05.2019, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 588, datë 28.01.2019 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit”.
39. Vendim nr. 618, datë 09.05.2019, “Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto””
40. Vendim nr. 619, datë 09.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.”
41. Vendim nr. 620, datë 13.05.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë””
42. Vendim nr. 621, datë 13.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK.”
43. Vendim nr. 622, datë 13.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK.
44. Vendim nr. 623, datë 23.05.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit Nr. 499, datë 15.02.2018 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil”
45. Vendim nr. 624, datë 31.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company”
46. Vendim nr. 625, datë 31.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve të shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga shoqëria Mol Germany GmbH”
48. Vendim nr. 627, datë 13.06.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës”
49. Vendim nr. 628, datë 13.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjiellës Kanalizime Tropojë” SHA”
50. Vendim nr. 629, datë 20.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjiellës Kanalizime Lushnjë” SHA”

51. Vendim nr. 630, datë 20.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe” SHA”
52. Vendim nr. 631, datë 20.06.2019 “Mbi autorizimin e përqendrit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ProQuest Holdings LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC”
53. Vendim nr. 632, datë 20.06.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 607, datë 01.04.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit””
54. Vendim nr. 633, datë 26.06.2019 “Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar”
55. Vendim nr. 634, datë 04.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin për këshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”
56. Vendim nr. 635, datë 04.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare”
57. Vendim nr. 636, datë 04.07.2019 “Mbi miratimin e “Kornizës së Procedurave të Autoritetit të Konkurrencës” (Competition Agency Procedures - CAP) në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN)””
58. Vendim nr. 637, datë 09.07.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit nr. 561, datë 15.10.2018 të KK për produktin TPL e brendshme”
59. Vendim nr. 638, datë 18.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve për ofrimin e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike”
60. Vendim nr. 639, datë 18.07.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 609, datë 10.04.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës””
61. Vendim nr. 640, datë 25.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë “Illyrian Guard” SHA”
62. Vendim nr. 641, datë 25.07.2019 “Mbi zbatimin periodik të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK”
63. Vendim nr. 642, datë 25.07.2019 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 592, datë 31.01.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo””
64. Vendim nr. 643, datë 25.07.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas””
65. Vendim nr. 644, datë 31.07.2019 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të Ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar”
66. Vendim nr. 645, datë 31.07.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të vendimit nr. 562 datë 15.10.2018” të KK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”
67. Vendim nr. 646, datë 09.08.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm””
68. Vendim nr. 647, datë 09.08.2019 “Për miratim paraprak me shkrim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të transferimit të kontratës së koncesionit të shoqërisë Dia Vita SHPK "Për shërbimin e hemodializës pranë spitaleve rajonale në Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan””
69. Vendim nr. 648, datë 19.09.2019 “Për mos klasifikimin si përqendrim të njoftimit mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB dhe dhënien e rekomandimeve Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.
70. Vendim nr. 649, datë 03.10.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”.
71. Vendim nr. 650, datë 03.10.2019 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA”.
72. Vendim nr. 651, datë 10.10.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë” SHA.
73. Nr. 652, datë 10.10.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”.

74. Vendim nr. 653, datë 17.10.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABC Neës SHA nga Z. Aleksandër Frangaj dhe Znj. Alba Ginaj”.
75. Vendim nr. 654, datë 23.10.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SKB Banka d.d. Ljubljana nga shoqëria OTP Bank Nyrt”.
76. Vendim nr. 655, datë 01.11.2019 “Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas”.
77. Vendim nr. 656, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Krujë” SHA”
78. Vendim nr. 657, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Vlorë” SHA”
79. Vendim nr. 658, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Himarë” SHA”
80. Vendim nr. 659, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje miratimin e një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”
81. Vendim nr. 660, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me procedurat e caktimit të ekspertëve për vlerësimin e dëmeve në sigurime, në procedurat gjyqësore”
82. Vendim nr. 661, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare””
83. Vendim nr. 662, datë 21.11.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë””
84. Vendim nr. 663, datë 03.12.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Avon Products, Inc nga shoqëria Natura Cosméticos S.A.”
85. Vendim nr. 664, datë 03.12.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët nga shoqëria Hyundai dhe shoqëria Kia Motors Corporation, mbi shoqërinë Ionity Holding GmbH & Co.KG”
86. Vendim nr. 665, datë 16.12.2019 “Mbi miratimin e Rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës””
87. Vendim nr. 666, datë 23.12.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Vorë” SHA”
88. Vendim nr. 667, datë 24.12.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksë (4+1 vende) në qytetin e Tiranës dhe dhënia e disa rekomandimeve.”
89. Vendim nr. 668, datë 24.12.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e profesionit të avokatit, noterit dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme”
90. Vendim nr. 669, datë 24.12.2019 “Për vijimin e hetimit të hapur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar”.
91. Vendim nr. 670, datë 24.12.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me shqyrtimin e procedurave për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike””
92. Vendim nr. 671, datë 24.12.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të tërthortë nga shoqëria EXOR N.V tek GEDI Grupoo Editoriale S.p.A.”
93. Vendim nr. 672, datë 24.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë””



**VENDIME TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS
“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE INSTITUCIONEVE PUBLIKE
DHE ENTEVE RREGULLATORE”
JANAR-DHJETOR 2019**

INSTITUCIONI	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës	Rekomandimet	Niveli i zbatueshmërisë
Bankës Qendrore të Shqipërisë	VKK Nr. 580, Datë 17.01.2019 “Mbi përfitimin e kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje”	Komisioni i Konkurrencës vendosi t'i rekomandojë Bankës Qendrore të Shqipërisë që: - Për çështje të stabilitetit financiar, të gjitha shoqëritë tregtare të kontrolluara nga Balfin SHPK që zotërojnë pozitën dominuese ose që do të marrin në të ardhmen këtë pozitë duhet të monitorohen dhe të trajtohen si aktivitete të lidhura me sistemin bankar, pavarësisht objektit të veprimtarisë së tyre. - Të parashtrojë përpara Autoritetit të Konkurrencës çdo ndryshim në strukturën e shoqërive të monitoruara, ku mund të krijohet ose forcohet pozita dominuese në treg.	Vendimi i KK është dërguar pranë BSH me shkresën nr. 104/1 datë 08.02.2019. BSH me shkresën nr.925 datë 29.01.2019 “Mbi vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 të KK”, shprehej se, në kuadër të mbikëqyrjes së veprimtarisë bankare, kryerja e veprimeve të përcaktuara në rekomandimet e mësipërme nuk ishte objekt i veprimtarisë së BSH dhe banka nuk disponon instrumentet në funksion të zbatimit të rekomandimeve.
	VKK Nr. 594, Datë 07.02.2019 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Bankën e Shqipërisë me Vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”	Komisioni i Konkurrencës vendosi t'i rekomandojë Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, zbatimin e Vendimit nr. 580, datë 17.01.2019 “Mbi përfitimin e kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Bank AD Skopje”, përkatësisht në pikën 2, gërma a) dhe b) e dispozitivit të këtij vendimi, të dhënë me kushte dhe detyrime.	Vendimi i KK është dërguar pranë BSH me shkresën nr. 104/1 prot, datë 08.02.2019. Këshilli Mbikëqyrës i BSH, nëpërmjet shkresës nr. 910/2 prot., datë 01.04.2019 “Kthim përgjigje”, vlerëson se çështjet e ngritura nga AK janë objekt i punës në ushtrim të funksioneve mbikëqyrëse të BSH në lidhje me personat e lidhur në marrëdhënie të veçante me bankën, por nuk mund të mbikëqyrë dhe të marrë masa për shoqëri tregtare që nuk ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare.
	VKK Nr. 613, Datë 19.04.2019 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Bankën e Shqipërisë me Vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”	Mospranimin e kërkesës nr. 910/2 prot., datë 01.04.2019 “Kthim përgjigje” të Bankës së Shqipërisë. Lënien në fuqi të rekomandimeve të dhëna sipas pikës 2, gërma a) dhe b) të Vendimit nr. 580, datë 17.01.2019 “Mbi përfitimin e kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje”.	Vendimi i KK është dërguar pranë BSH me shkresën nr. 484/17 prot, datë 06.09.2019. BSH ka depozituar shkresën nr. 484/18 datë 19.09.2019 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të vendimeve të KK” nëpërmjet të cilës BSH informon se ka parashikuar një regjim specifik mbikëqyrës për Bankën Tirana, i cili ndiqet dhe monitorohet vazhdimisht.

**AMF - Autoritetit
të Mbikëqyrjes
Financiare
(BANKAT)**

VKK Nr. 585, Datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare :

- a) Të marrë masa që bankat e nivelit të dytë, të cilat ofrojnë shërbimin e ndërmjetësimit të sigurimeve për klientët e tyre, të pajisen me licensat përkatëse të ndërmjetësimit në sigurime.
- b) Të përcaktojnë metodologjinë për përlogaritjen e primit të sigurimit të pronës dhe jetës nga shoqëritë e sigurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të kërkojnë nga shoqëritë e sigurimit orientimin e primeve të sigurimit drejt kostos.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, brenda 6 muajve nga marrja e këtij vendimi, duhet të informojë Autoritetin e Konkurrencës mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në pikën 1 dhe 2 të vendimit.

Tregu i ndërmjetësimit të sigurimeve nga bankat e nivelit të dytë do të monitorohet për një periudhë 1 vjeçare nga marrja e vendimit.

VKK Nr. 605, Datë 21.03.2019 “Mbi mospranimin e kërkesës se AMF për rishikimin e Vendimit nr.585, datë 24.01.2019 “Për mbylljen e

Komisioni i Konkurrencës vendosi mospranimin e kërkesës së AMF-së për rishikimin e Vendimit nr. 585 datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime dhe bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe

BSH konstaton se nga monitorimi i ekspozimeve të personave në marrëdhënie të veçantë me bankën, lidhur me të në mënyrë direkte dhe indirekte, referuar matjes së këtyre ekspozimeve kundrejt kapitalit rregullator, nuk rezultojnë shkelje të kërkesave të Ligjit për Bankat apo akteve të tjera rregullatorë

BSH ka zbatuar rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Konkurrencës, sipas vendimeve përkatëse.

Vendimi i KK është dërguar pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me shkresën nr. 88 prot., datë 30.01.2019, dhe pranë Raiffeisen Bank; Banka Kombëtare Tregtare (BKT); Banka Credins; ALFA Bank me nr. 90, datë 30.01.2019.

AMF nëpërmjet shkresës nr. 447/1 prot, datë 22.02.2019 kërkon rishikimin e vendimit nr. 585, datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”, për ndryshimin e pikës 3 dhe 4 të vendimit të AK.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me shkresën nr. 88/3 prot, datë 25.03.2019.

AMF me shkresën nr. 3602/4, datë 09.05.2019 protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me

	procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”	rekomandimeve” dhe lënien në fuqi të rekomandimeve të dhëna sipas pikës 3 të këtij vendimi.	nr.4363/14 prot. datë 09.05.2019, ka kthyer përgjigje që në zbatim të vendimit 585, datë 24.01.2019, ka hartuar një plan pune për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga KK, brenda afatit të caktuar 6 mujor. AMF në lidhje me rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr. 447/4 datë 23.07.2019, ka ndërmarrë hapat e mëposhtëm: -Ka patur komunikime në BSH lidhur me miratimin nga BSH të bankave që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e brokerimit. - Ka kryer inspektive pranë shoqërive të sigurimit në lidhje me marrëveshjet që këto të fundit kanë me bankat e nivelit të dytë, si ndërmjetës në sigurime, dhe ka marrë disa vendime për problematikat e konstatuara Gjithashtu AMF sqaron se: <i>“Përcaktimi i një metodologjie standarde të llogaritjes së primit do të ishte në dëm të konkurrencës së tregut si dhe do të mund të sillte efekte negative në shëndetin financiar të disa prej kompanive të sigurimit”</i> Mungesa e kësaj metodologjie e bën të pamundur vlerësimin e sjelljes së bankave apo kompanive të sigurimit dhe analizën e vlerës së “primit të drejtë”, edhe pse u konstatuan komisione shumë të larta brokerimi për shërbimin e ndërmjetësimit nga bankat nga AK. Nga sa më sipër, AMF ka zbatuar plotësisht rekomandimin e parë dhe pjesërisht rekomandimin e dytë.
AMF - Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (PRODUKTI TPL)	VKK Nr. 637, Datë 09.07.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit Nr. 561, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës për	Komisioni Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë AMF zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 561, datë 15.10.2018, brenda një periudhë 6 mujore. Të raportojë pranë AK për përmbushjen e rekomandimeve.	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë AMF me shkresën nr. 222/10 prot, datë 11.07.2019. Rekomandimet e dhëna në pikën II, gërmat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, dhe “f” të dispozitivit të vendimit nr. 561, datë 15.10.2018, janë realizuar nga AMF. Lidhur me gërmen

ERRU – Entit Rregullator të Ujit

produktin TPL e brendshme”

“g” të këtij vendimi, AK mirëpret rastet që do të paraqiten në të ardhmen nga AMF për të cilat konstaton sjellje antikonkurrese nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

VKK Nr. 593, Datë 07.02.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA””

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:

1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve.
2. ERRU të publikojë dhe bëjë transparente brenda 30 ditëve vendimin e tij ku të përfshijë të gjithë informacionin mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK me anë të Vendimit Nr.492, datë 28.12.2017 të Komisionit të Konkurrencës.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit (ERRU) me shkresën nr. 699/3 prot, datë 20.02.2019.

ERRU nëpërmjet faqes së web, ka publikuar vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 07, datë 08.02.2019 për “Miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Gjirokastër SHA”.

ERRU ka zbatuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës.

VKK Nr. 600, Datë 15.03.2019 “Mbi dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Poliçan SHA””

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:

1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Poliçan SHA të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve.
2. ERRU të kërkojë nga Ujësjellës Kanalizime Poliçan SHA ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara: a) shërbimi i furnizimit me ujë dhe b) shërbimi i largimit të ujërave të ndotura, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
3. ERRU të publikojë dhe të bëjë transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi, të gjithë informacionin mbi aplikimin për

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr. 722/2 prot, datë 25.03.2019.

ERRU nëpërmjet faqes së web, ka publikuar vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 08, datë 08.02.2019 për “Miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Poliçan SHA”.

Komisioni i Konkurrencës ka vijuar me vlerësimin ex-post të aktit të ERRU të lartpërmendur.

ndryshimin e tarifave, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK, për ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura, sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU.

VKK Nr. 602, Datë 21.03.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Delvinë SHA””

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:

1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Delvinë SHA të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve.
2. ERRU të kërkojë nga Ujësjellës Kanalizime Delvinë SHA ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara: a)shërbimi i furnizimit me ujë dhe b) shërbimi i largimit të ujërave të ndotura, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
3. ERRU të publikojë dhe të bëjë transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi, të gjithë informacionin mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK, për ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura, sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr. 57/2 prot, datë 25.03.2019.

ERRU nëpërmjet faqes së web, ka publikuar vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 13, datë 06.03.2019 për “Miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Delvinë SHA.”

Komisioni i Konkurrencës, ka vijuar me vlerësimin ex-post të aktit të ERRU të lartpërmendur.

VKK Nr. 628, Datë 13.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:

1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr. 320/2, datë 14.06.2019.

nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Tropojë SHA””	Tropojë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve. 2. ERRU të kërkojë nga Ujësjellës Kanalizime Tropojë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara: a) shërbimi i furnizimit me ujë dhe b) shërbimi i largimit të ujërave të ndotura, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi. 3. ERRU të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.	ERRU nëpërmjet faqes së web, ka publikuar vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 20.06.2019 për “Miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Tropojë SHA” ERRU ka zbatuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës.
VKK Nr. 629, Datë 20.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Lushnjë SHA””	Komisioni Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit: 1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Lushnjë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve. 2. ERRU të kërkojë nga Ujësjellës Kanalizime Lushnjë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi. 3. ERRU të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr. 321/2, datë 24.06.2019. ERRU nëpërmjet faqes së web ka publikuar vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41 datë 27.08.2019 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Lushnjë SHA”. ERRU ka zbatuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës.
VKK Nr. 630, Datë 20.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit	Komisioni Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr. 342/2, datë 24.06.2019.

Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe SHA””

1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve.
2. ERRU të kërkojë nga Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
3. ERRU të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

ERRU nëpërmjet faqes së web, ka publikuar vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 30, datë 20.06.2019 për “Miratimin e tarifave të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Malësi e Madhe SHA”.

ERRU ka respektuar vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës.

VKK Nr. 651, Datë 10.10.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA””

Komisioni Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:

1. Tarifat e unifikuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. ERRU të kërkojë nga Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
3. ERRU të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr. 516/2 prot., datë 11.10.2019.

ERRU me shkresën nr. 342/2 prot., datë 30.10.2019, ka informuar se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës.

VKK Nr. 656, Datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për

Komisioni Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:

1. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Krujë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr. 569/2 Prot., datë 03.12.2019.

ERRU nëpërmjet faqes së web, ka publikuar vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 52, datë 28.10.2019 për “Miratimin e tarifave të shërbimit të

ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Krujë SHA””

2. ERRU të kërkojë nga Ujësjellës Kanalizime Krujë SHA ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
3. ERRU të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos, përfshirë dhe kontabilizimin e investimeve të financuara. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Krujë SHA”.

ERRU ka respektuar vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës.

VKK Nr. 657, Datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA””

Komisioni Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:

1. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. ERRU të kërkojë nga Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
3. ERRU të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr.550/2 prot., datë 03.12.2019

ERRU nëpërmjet faqes së web, ka publikuar vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 51, datë 28.10.2019 për “Miratimin e tarifave të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Vlorë SHA”.

ERRU ka respektuar vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës.

VKK Nr. 658, Datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Himarë SHA””

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:

1. Tarifat e unifikuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Himarë SHA të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. ERRU të kërkojë nga Ujësjellës Kanalizime Himarë SHA ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara,

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr.549/2 prot., datë 03.12.2019

ERRU nëpërmjet faqes së web, ka publikuar vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 53, datë 28.10.2019 për “Miratimin e tarifave të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Himarë SHA”

**ERE – Entit
Rregullator të
Energjisë**

duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.

3. ERRU të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

VKK Nr. 666, Datë 23.12.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Vorë SHA””

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:

1. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Vorë SHA të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.

2. ERRU të kërkojë nga Ujësjetllës Kanalizime Vorë SHA ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.

3. ERRU të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

ERRU ka respektuar vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Ujit me shkresën nr. 654/2 prot., datë 26.12.2019

ERRU nëpërmjet faqes së web, ka publikuar vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 68, datë 19.12.2019 për “Miratimin e tarifave të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjetllës kanalizime Vore SH.A”

ERRU ka respektuar vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës.

VKK Nr. 670 Datë 24.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me shqyrtimin e procedurave për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”.

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë ERE-s:

I. T’i rekomandojë ERE-s që gjatë procedurës së miratimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, të marrë në konsideratë:

a. Përcaktimi i qartë i afatit kohor të zbatimit Dry-run si pjesë përbërëse e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

b. Shfuqizimin e të gjitha akteve të mëparshme rregullatorë që rregullojnë balancimin në sektorin

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Entit Rregullator të Energjisë me shkresën nr. 554/2 prot., datë 26.12.2019.

ERE me shkresën nr. 554/3 prot., datë 14.01.2020, OST me shkresën nr. 554/4 prot., datë 21.01.2020, gjithashtu ERE shkresën nr. 474/4 prot., datë 04.02.2020 **kanë informuar AK se ka respektuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës.**

elektroenergjitik shqiptar, pas miratimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

c. Raporti përmbledhës mbi eksperiencën e fituar nga zbatimi i rregullave nga OST SHA duhet të jetë i detyruar.

d. Unifikimin e afatit të marrëveshjes për Ofruesit të Shërbimit të Balancimit si në draft rregullat ashtu dhe në aneksin e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

e. Përcaktimi i qartë i kostos së tarifës për Palën Përgjegjëse Balancuese nga OST dhe palët e interesit, kosto të cilat duhet të jenë të justifikuara dhe argumentuara, bazuar në përcaktimet e “Metodologjisë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike” miratuar me Vendimin e bordit të EREs nr. 180, datë 08.11.2017.

f. Përcaktimin e qartë të kriterëve për Palën Përgjegjëse të Balancimit (PPB) të mundësisë së fundit, si edhe të Autoritetit Përgjegjës për përcaktimin e PPBsë. Analogjia me Furnizuesin e Mundësisë së Fundit (OSHEE aktualisht) nuk gjen mbështetje në ligj, pasi ligji nuk parashikon PPB të mundësisë së fundit, për më tepër që rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit mund ta kryejë çdo furnizues që përcaktohet si i tillë dhe jo vetëm OSHEE.

g. Mënyra e llogaritjes së kostove në kushtet e Palës Përgjegjëse Balancuese (PPB-së), të mundësisë së fundit të jetë e përcaktuar si pjesë përbërëse e këtyre rregullave.

h. Të përcaktohet qartë mënyra e shpërndarjes së përfitimeve financiare të mundshme të OST SHA gjatë operimit të këtij tregu tek klientët si pjesë e këtyre rregullave.

VKK Nr. 659, Datë 21.11.2019 “Për dhënie të disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë ERE-s që gjatë procedurës së miratimit të një ndryshim në rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e

Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr. 489/2 prot., datë 03.12.2019 ka dërguar pranë ERE kopje të vendimit të KK.

AKEP - Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

lidhje miratimin e një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".

shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, të marrë në konsideratë:

1. Shqyrtimin e procedurave të aplikimit për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, konform parashikimeve dhe afateve të përcaktuara në pikën 1, neni 21 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s".
2. Të kërkohet dhe të përcaktohet qartë periudha tranzitore për aplikimin e ndryshimit të kërkuar nga ana e OSHEE SHA në blerjen e energjisë në përputhje me parashikimet ligjore të lidhur me afatin e kontratave për cmimin e blerjes së energjisë, bazuar në një kthim të arsyeshëm, një kohëzgjatje të arsyeshme të përcaktuar dhe brenda afatit të periudhës tranzitore 30.09.2019 të miratuar nga ERE.

ERE është në proces të vendimmarrjes për këto procedura.

VKK Nr. 634, datë 04.07.2019 "Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin për këshillim publik "Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare"

Komisioni i Konkurrencës vendosi t'i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare:

1. Të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
2. Vendorsjen e masave rregullatore përkatëse duke vendosur edhe masën rregullatore të mos-diskriminimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (on-net/off-net rule) për operatorin që ka pozitë dominuese dhe heqjen e masës rregullatore të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net për operatorët që nuk kanë FNT në tregun me pakicë.
3. Shmangien e subvencionimit nga të ardhurat e realizuara në tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nga operatorët me FNT në tregun e

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) me shkresën nr. 293/4 prot, datë 05.07.2019.

Dokumentet e AKEP aktualisht janë publikuar në faqen zyrtare për konsultim publik, dhe vetë institucioni është në realizimin e procedurave të tij.

shitjes me pakicë, për aplikimin e tarifave nën kosto.

VKK Nr. 635, Datë 04.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare”

Komisioni Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare:

1. Te analizoje analizen e tregut të pakices të tregut të telefonise celulare per te ndermarre masat e nevojshme rregullatore per rregullimin e ketij tregu, per percaktimin e ndermarrjes “Vodafone Albania” SHA me FNT ne tregun me pakice te sherbimeve celulare dhe vendosjen e masave rregullatore perkatese.
2. Sjelljen ne vemendje te zbatimit te Vendimit te Komisionit te Konkurrences Nr.568, datë 15.11.2018 “Per dhenjen e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare ne tregun e sherbimeve celulare”:
 - Të vendosë nën rregullim tarifat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjen me FNT, sipas parashikimeve të Ligjit Nr.9918/2008 të njëkohëshme me tregun me shumicë të akses-origjinimit, për nxitjen e konkurrencës efektive në këtë treg, pa pritur rezultatet e rregullimit të tarifave të tregut të akses-origjinimit;
 - Rregullimi i tarifave me pakicë për operatorin me FNT duhet të adresojë problemet e evidentuara nga analiza e tregut e AKEP, si
 - i. on-net vs off-net në mungesë të masave të rregullimit të tarifave të shumicës për terminimin e thirrjeve;
 - ii. Tarifat standard jashtë ofertave janë shumë të larta;
 - Krijimin e lehtësirave për hyrjen në treg të MVNO-ve, duke vendosur detyrime të qarta për ndërmarrjen me FNT për akses

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) me shkresën nr. 293/4 prot, datë 05.07.2019

Dokumentet e AKEP aktualisht janë publikuar në faqen zyrtare për konsultim publik dhe vetë institucioni është në realizimin e procedurave të tij.

- dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit.
3. Sjelljen në vëmendje të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr.475, datë 21.09.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve”, në pikën 1.3.e të tij i është rekomanduar AKEP si vijon:
 - a. Të kryejë analiza për zhvillimin dhe orientimin drejt kostos së tarifave standarde të aplikuara për përdoruesit me parapagesë, që përdorin tarifatat standarde jashtë ofertave për operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg.
 4. Autoriteti i Konkurrencës i kërkon AKEP që në bazë të nenit 70 të Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe nenit 38 të ligjit “Për komunikimet elektronike” të vërë në dispozicion të gjithë dokumentet që zotëron lidhur me abuzimin e mundshëm me Pozitën Dominuese ose sjelljet e koordinuara të përshkruar në dokument. Ky informacion do të mundësonte hapjen ose jo të procedurave hetimore të parashikuara në Ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
 5. Monitorimin e tregut të telefonisë celulare për një periudhë 6 (gjashtë) muaj nga dalja e këtij vendimi.

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare:

4. Të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

**“VODAFONE
ALBANIA” SHA**

VKK Nr. 661, Datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare””

Komisioni Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare: Përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”, të vlerësojë: - Komentet e Vodafone Albania,depozituar në AKEP datë 18.06.2019 lidhur me Analizën e Tregut të shërbimeve celulare në përgjithësi. - Të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit European për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2018/C 159/01) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik.

5. Vendorsjen e masave rregullatore përkatëse duke vendosur edhe masën rregullatore të mos-diskriminimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (on-net/off-net rule) për operatorin që ka pozitë dominuese dhe heqjen e masës rregullatore të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net për operatorët që nuk kanë FNT në tregun me pakicë.
6. Shmangien e subvencionimit nga të ardhurat e realizuara në tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nga operatorët me FNT në tregun e shitjes me pakicë, për aplikimin e tarifave nën kosto.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe VODAFONE ALBANIA sha me shkresën nr.540/7 prot., datë 03.12.2019.

AKEP nuk ka akoma vendimmarrje për këtë procedurë.

**Ministritë së
Shëndetësisë dhe
Mbrojtjes Sociale
dhe
Urdhrit të
Stomatologut**

VKK Nr. 599, Datë 15.03.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike dhe dhënien e disa rekomandimeve”

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që:

- a) Në respektim të nenit 69 dhe 70 të ligjit, të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ i cili mund të sjellë kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; që synon vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose produkte të caktuara; apo projekt akte normative të cilat imponojnë praktika të njëjta në çmime dhe kushte të shitjes;
- b) Të krijojnë paraprakisht mendimin e Autoritetit të Konkurrencës në rastet kur parashikohen metodologji të përcaktimit të tarifave apo rishikime të tarifave në shërbimin stomatolog;
- c) Tarifat që i ofrohen konsumatorëve në shërbimin stomatolog, duhet të jenë të orientuara drejt kostos.

T’i rekomandojë Urdhrit të Stomatologut që:

Në rastet e marrjes së vendimeve nga organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut, në lidhje me aspekte të ndryshme të cilat prekin konkurrencën në treg, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, të respektohen dispozitat e Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës është dërguar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 59/8 prot, datë 25.03.2019.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka njoftuar me shkresën nr. 785/1, datë 13.02.2019 se Urdhri i Stomatologut të RSH lidhur me Vendimin e Asamblesë Kombëtare të datës 07.02.2019 ka anuluar vendimin e mëparshëm të tij lidhur me vendosjen e çmimeve dysHEME për shërbimet në klinikat dentare.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka zbatuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës.

**Ministritë së
Drejtësisë**

VKK Nr. 638, Datë 18.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve për ofrimin e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike”

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Drejtësisë:

- a) Të rishikojë Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 279, datë 14.06.2012 “Për Miratimin e tarifave të shërbimeve noteriale” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, duke përcaktuar tarifa noteriale konkurruese,

Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr. 193/11, datë 30.07.2019 ka dërguar pranë MD kopje të vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

lidhur me ofrimin e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike.

b) Tarifat për shërbimet noteriale, të jenë të orientuara drejt kostos dhe të bazuara në një metodologji të përlllogaritjes së tyre.

c) Të dërgojë për mendim pranë Autoritetit të Konkurrencës projekt aktet nënligjore të cilat kanë të bëjnë me përcaktimet e tarifave apo vendosjen e kufizimeve të ndryshme, në zbatim të nenit 69 të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

VKK Nr. 660, Datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me procedurat e caktimit të ekspertëve për vlerësimin e dëmeve në sigurime, në procedurat gjyqësore”

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Drejtësisë krijimin, administrimin dhe publikimin e Regjistrit Elektronik për Ekspertët vlerësues të dëmeve në sigurime, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. 4 2. Me krijimin e Regjistrit Elektronik të Ekspertëve, Ministria e Drejtësisë njofton edhe Autoritetin e Konkurrencës.

Ministria e Drejtësisë është në proces të miratimit të kuadrit nënligjor në zbatim të Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”.

Autoriteti i Konkurrencës është në proces monitorimi.

Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr.340/30 Prot., 10.12.2019 ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë kopje të vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

Ministria e Drejtësisë me shkresën Nr.8176/1, datë 23.12.2019 është përgjigjur se: në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuar në nenin 224/d të K.Pr.Civile dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë, ne.10619, datë 19.10.2018, “Për krijimin Administrimin dhe Vënien në Dispozicion për Publikun të Regjistrit Elektronik për Ekspertët” Ministria e Drejtësisë ka publikuar në faqen zyrtare të saj listën e ekspertëve të cilët plotësojnë kriteret ligjore për regjistrim në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve. Kjo listë ndahet në seksione të ndryshme, duke grupuar ekspertët sipas fushave të tyre të ekspertizës dhe vendit ku ata ushtrojnë aktivitetin e tyre. Nga monitorimi i faqes web të Ministrisë së Drejtësisë rezulton se po vijon procesi i krijimit të regjistrit të ekspertëve.

Ministria e Drejtësisë ka marrë në konsideratë rekomandimet e VKK nr. 660, dt.21.11.2019.

**Ministrisë së
Drejtësisë;
Dhomës së
Avokatisë;
Dhomës Kombëtare
të Noterëve;**

**Ministrisë së
Infrastrukturës dhe
Energjinë**

**Shoqatës së
Vlerësuesve të
Pasurive**

**Bankave të nivelit
të dytë**

VKK Nr. 668, Datë 24.12.2019 “Për dhënie e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e profesionit të avokatit, noterit dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme”

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’u rekomandojë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë që lidhur me profesionin e avokatit:

1.1.Plotësimin e kuadrit nënligjor përkatës në fushën e avokatisë bazuar në dispozitat e ligjit 55/ 2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”;

1.2.Dërgimin për mendim dhe vlerësim të draft-akteve nënligjore të hartuara nga organet përkatëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, të shoqëruara me relacionet përkatëse dhe në rastet e hartimit të akteve nënligjore që përcaktojnë tarifa, ky draft akt të jetë i shoqëruar edhe me metodologji të përlllogaritjes së tarifave, me qellim vlerësimin e tyre konform ligjit 9121/2003.

1.3.Respektimin e dispozitave ligjore duke ofruar transparencë lidhur me shërbimet dhe çmimet që ofron profesioni i avokatit. Mundësi aksesimi nga të gjithë konsumatorët i informacionit të nevojshëm.

1.4.Kryerja e amendimeve të nevojshme në Statutin e Dhomës së Avokatisë dhe Kodin e Etikës;

1.5.Faqja zyrtare e web e DHKA të pasqyrojë gjithë informacionin e nevojshëm përfshirë edhe informacionet lidhur me trajnimet që duhet të ofrojë dhoma.

2. .Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterëve që lidhur me profesionin e noterit:

2.1.Plotësimin e kuadrit nënligjor përkatës në fushën e noterisë bazuar në dispozitat e ligjit të 110/ 2018 “Për Noterinë”.

2.2.Dërgimin për mendim dhe vlerësim të draft-akteve nënligjore të hartuara nga organet përkatëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, të shoqëruara me relacionet përkatëse dhe në rastet e hartimit të akteve nënligjore që përcaktojnë tarifa, ky draft akt të jetë i shoqëruar edhe me metodologji të përlllogaritjes së tarifave, me qellim vlerësimin e tyre konform ligjit 9121/2003.

Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr. 431/2 prot., datë 26.12.2019 ka dërguar shkresë Ministrisë së Drejtësisë; Dhomës së Avokatisë; Dhomës Kombëtare të Noterëve; Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjinë dhe Shoqatës së Vlerësuesve të Pasurive, Bankave të nivelit të dytë.

Ministria e Drejtësisë me shkresën 8276/1 datë 23.12.2019 ka informuar AK se ka përmbushur rekomandimet e Komisionit të Konkurrencës.

2.3.DHKN duhet të ofrojë asistencën e duhur noterëve lidhur me trajnime të vazhdueshme dhe kualifikime;
2.4.Kur të draftohet urdhri i ri “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”, të merret në konsideratë mundësia lidhur me unifikimin e përmasave të tabelave, llojit të shkrimit, vetë ngjyrës së tabelës duke ofruar të njëjtin perceptim për konsumatorët dhe pa manipuluar zgjedhjen konsumatore.

2.5.Përfshirja e AK për evidentimin e problematikave të ndryshme që mund të ekzistojnë dhe prekin fushën e konkurrencës. Organizimi dhe pjesëmarrja në seminare/konferenca lidhur me konkurrencën në tregun e ofrimit të shërbimeve të profesioneve të lira.

3. .Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjinë dhe Shoqatës së Vlerësuesve të Pasurive:

3.1.Rishikimin e kuadri ligjor ekzistues duke parashikuar dispozita ligjore për organizimin dhe funksionimin e SVP.

3.2.Në rast rishikimi të Udhëzimit Nr. 4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve të ekspertëve në gjykatë”, të merret mendimi i Autoritetit të Konkurrencës para miratimit të ndryshimeve. Përcaktimi i pagesave dhe tarifave të ekspertëve në çdo rast duhet të jenë të orientuara drejt kostove të ofrimit të shërbimit, të shoqëruara me metodologji të përlllogaritjes së tyre dhe relacione shpjeguese.

3.3.Dërgimi për mendim pranë AK të çdo projekt akti i cili synon të përcaktojë tarifa, të vendosë barriera për hyrjen në treg, të shoqëruara me relacionet dhe dokumentet shoqëruese përkatëse. 3.4.Kurset dhe provimet e kursit të formimit të vazhduar të jenë cilësore për të prodhuar diploma/certifikata cilësore me standard. 3.5.Të hartohen standarde shqiptare të vlerësimit si edhe të ngrihet një organizëm i pavarur me anëtarë profesionistë të licencuar për kontrollin dhe monitorimin e standardeve dhe Etikës së ekspertëve.

**Ministrisë së
Infrastrukturës dhe
Energjisë**

VKK nr. 645, Datë 31.07.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Vendimit nr. 562, datë 15.10.2018” të Komisionit të Konkurrencës në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në RSH”

Në zbatim të nenit 69 të ligjit 9121/2003 “ Për mbrojtjen e Konkurrencës” t’i kërkojë MIE liberalizimin e tregut, duke qenë se Kontrata e Koncesionit datë 03.09.2009 “Për shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë” përfundon në 03.09.2019.

Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr. 66/5, datë 31.07.2019 ka dërguar pranë MIE kopje të vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës është informuar nga MIE për miratimin e VKM nr. 880, datë 24.12.2019. Rekomandimet e dhëna në pikën 1 të dispozitivit të VKK nr. 645 datë 31.07.2019, janë marrë në konsideratë nga MIE si dhe tregu i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në RSH është liberalizuar.

Vendimi i KK është zbatuar nga MIE.

3.6.Në rast rishikimi të VKM Nr. 712 datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”, të shikohet mundësia e heqjes së kufizimeve që pengojnë hyrjen në treg, lehtësimin e kushteve dhe kriterëve për të marrë licencën e VPP duke lehtësuar hyrjen në treg të profesionistëve të rinj.

3.7.Të forcohet roli i shoqatës së vlerësuesve, si kusht për rritjen e cilësisë së shërbimeve të vlerësimit, vendosjen e kontakteve me organizata e shoqata të së 10 njëjtës natyrë dhe shkëmbimi i përvojës me ta; hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë ngritjen profesionale.

4. Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë bankave të nivelit të dytë: Shpërndarja e vlerësimeve duhet të kryhet tek të gjithë vlerësuesit e përzgjedhur. Procesi i përzgjedhjes së vlerësuesve duhet të jetë transparent dhe të zbatohen deri diku parimet e prokurimit publik ku vlerësuesit të konkurrojnë midis tyre nëpërmjet parimeve të mirënjohura mbi të cilat funksionon dhe rregullohet ky profesion.

**Ministrisë së
Financave dhe
Ekonomisë**

VKK nr. 646, Datë 09.08.2019 “Për dhënie e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për sa më poshtë:

1. Në nenin 14 të Draft Kontratës “*Tarifa e Shërbimit, tarifa koncesionare dhe mënyra e pagesës*” në rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit:
 - a. Të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet depozitimit të dokumentacioneve shoqërues, për të cilat kërkohet ndryshimi i tarifave, për faktin se e drejta e dhënë në ofrimin e këtij shërbimi krijon një të drejtë ekskluzive.
 - b. Ndryshimi i tarifave të shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati/instrumenti matës të njoftohet paraprakisht për vlerësim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
 - c. Ndryshimet e tarifave të shërbimit duhet të jenë të argumentuara, të bazuara në një metodologji të përllogaritjes së tyre, dhe të jenë tarifa të orientuara drejt kostos.
 - d. Detyrimin që si autoritet kontraktor të hartojë një metodologji për vendosjen e përqindjes për instrumentet matëse të verifikuara që rezultojnë me probleme si dhe të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës për shkak të së drejtës ekskluzive që fitohet nga ndërmarrja “Noa Control” SHPK.
2. Pika 3 e nenit 14 të draft kontratës së koncesionit, të rishikohet, për sa më poshtë:

Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr. 467/5, datë 13.08.2019 ka dërguar pranë MFE kopje të vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

MFE, me shkresën nr. 15009/1, datë 17.09.2019 “Lidhur me zbatimin e vendimit të KK nr. 646 prot, datë 09.08.2019” dhe shkresën nr.15009/3 Prot., datë 16.10.2019 “Lidhur me shkresën tuaj për kërkim informacioni” na informon se rekomandimi i dhënë nga AK është realizuar në mënyrë të pjesshme nga MFE.

**KESH -
Korporatës
Energjitike
Shqiptare**

VKK nr. 644, Datë 31.07.2019 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës vendosi, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SH.A:

- a. Përqindja e përcaktuar e totalit të instrumenteve matës të verifikuar që rezultojnë me probleme, duhet të përcaktohet në bazë të një metodologjie të miratuar nga autoriteti kontraktor;
- b. Periudha tranzitore duhet të jetë e përcaktuar në terma konkretë, duke ju referuar një afati kohor në: muaj, vit apo vite;
- c. Rritja e frekuencës së verifikimit të instrumenteve matës duhet të adresohet vetëm për ato “subjekte të detyruara” tek të cilat rezultojnë problematika dhe jo për të gjithë subjektet e detyruar;

Të njoftohet Autoriteti i Konkurrencës mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr.24/15 , datë 01.08.2019 ka dërguar pranë KESH SHA kopje të vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

Nga KESH SHA nuk kemi njoftim për zbatimin e VKK.

- a. Detyrimin e ndërmarrjes KESH Sh.a në zbatim të Vendimit nr. 93/2019 të ERE të ndërpresë vazhdimësinë e këtyre dy kontratave.
- b. Detyrimin e ndërmarrjes KESH Sh.a të njoftojë Sekretariatën e Energjisë më Vjenë për ecurinë e zbatimit të Vendimit nr. 93/2019 të ERE.
- c. Detyrimin e ndërmarrjes KESH Sh.a të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës për ecurinë e zbatimit të Vendimit nr. 93/2019 të ERE.
- d. Detyrimin e ndërmarrjes KESH Sh.a, si operator me pozitë dominuese, për çdo kontratë të ardhshme, e cila vendos

të drejta të veçanta ose ekskluzive, për ndërmarrje (kompani) ose për produkte të caktuara, të kërkojë një vlerësim paraprak nga Komisioni i Konkurrencës.

**Shoqërisë
“Illyrian Guard”**

VKK Nr. 640, Datë 25.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë “Illyrian Guard” SHA”

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë shoqërisë “Illyrian Guard” SHA, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj të respektojë parimet e konkurrencës dhe dispozitat ligjore që burojnë nga Ligji nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe sidomos respektimin e nenit 9 të këtij ligji.

AK me shkresën nr. 354/8 Prot.,datë 01.08.2019 ka dërguar pranë Shoqërisë “Illyrian Guard” SHA kopje të vendimit të KK.

AK është në monitorim të sjelljes së Illyrian Guard.

**Ministrisë së
Shëndetësisë dhe
Mbrojtjes Sociale**

VKK Nr. 648, Datë 19.09.2019 “Për mos klasifikimin si përqendrim të njoftimit mbi përftimin e kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB dhe dhënien e rekomandimeve Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”

Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, transferimi i çdo të drejte ekskluzive ose te veçantë të shoqërohet nga vlerësimi i kriterit të përshtatshmërisë sipas parashikimeve ligjore

Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr. 410/19 prot., datë 20.04.2019 ka dërguar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kopje të vendimit të KK.

Pranë AK nuk është paraqitur ndonjë rast/çështje.

Çështje të mbartuara për gjykim në vitin 2020

Çështje të mbartuara për gjykim nga Gjykata Administrative e Apelit:

1. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Ekma Albania” SHPK, të paditur AK me objekt: Shfuqizimi i vendimit nr. 572, datë 22.11.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “Ekma Albania” SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.
2. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Ekma Albania” SHPK, të paditur AK me objekt: Shfuqizimi i vendimit të AK me nr. 542, datë 04.09.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agraro-ushqimore në qytetin e Tiranës”. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Administrative e Shkallës së parë vendosi të pranojë kërkesë padinë duke shfuqizuar vendimin e AK.
3. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “SGS Automotive Albania” SHPK, të paditur AK me objekt: Shfuqizimin e vendimit nr. 562, datë 25.10.2018 “Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”.
4. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Vodafone Albania”, të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i vendimit nr. 495, datë 08.02.2018 i KK në lidhje me aplikimin e gjobës ndaj subjektit paditës në masën 3.011.173 lekë. Rregullimin e pasojave të ardhura nga paligjshmëria e akteve administrative, duke detyruar të paditurin t'i kthejë paditësit masën e gjobës së paguar”.
5. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Telekom Albania”, të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i pjesshëm i Vendimit Nr. 495 datë 08.02.2018 i KK, me titull “Për vendosjen e Gjobës ndaj Ndërmarrjeve Telekom Albania sha dhe Vodafone Albania sha për mos përmbushjen e detyrimit të vendosur nga KK në Vendimin nr. 475 datë 21.09.2017, vetëm për pjesën e aktit administrativ që i përket Shoqërisë Telekom Albania sha”.
6. Çështja administrative me paditës AK, i paditur, ndërmarrja “Tirana-Lines” dhe palë e tretë Zyra Përmbartimore Tiranë, me objekt: Kundërshtim veprimesh përmbartimore. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, vendosi pranimin e padisë së AK, duke detyruar Zyrën e përmbartimit Tiranë që të vazhdojë me ekzekutimin e pjesës së mbetur të detyrimit.
7. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “Armo” Sha, i paditur AK, me objekt: Kundërshtimin e vendimit të KK nr. 150, datë 20.07.2010 ‘për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Armo” Sha në tregun e prodhimit të produktit lëndë djegëse diesel D2”. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2441, datë 17.10.2012, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 5681, datë 28.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr. 150, datë 20.07.2010 të KK. Kundër këtij vendimi, AK paraqiti rekurs pranë Gjykatës së Lartë,

e cila me vendimin nr. 1445, datë 04.07.2017 vendosi kthimin për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

Çështje të mbartuara për gjykim nga kolegji administrativ i Gjykatës së Lartë:

1. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “EMS APO”, të paditur AK, me objekt “Shfuqizimi i vendimit të KK nr. 451, datë 28.02.2017 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë me Vendimin nr. 80-2017-3056, datë 10.07.2017 ku është vendosur: Rrëzimi i kërkesë padisë dhe lënia në fuqi e vendimit të AK.
2. Çështja administrative me: paditës ndërmarrjen “Hyundai” Shpk, i paditur AK, me objekt: “Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimi të KK nr. 154, datë 01.10.2010 “Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve “Classic” Shpk, “Hyundai Auto Albania” Shpk, “Noti” Shpk dhe “Ultra Motors” Shpk dhe vendosje gjobe ndaj tyre për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”, lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje me vendimin nr. 4553, datë 21.09.2015 ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë, duke lënë në fuqi vendimin e AK. Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Kjo gjykatë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së parë duke u shprehur në favor të Autoritetit të Konkurrencës.
3. Çështja administrative me kërkuar ndërmarrjen “EMS APO” person i tretë AK, me objekt: Pezullimi tërësisht i masave të përkohshme, të vendosura me vendimin e KK nr. 451, datë 28.02.2017 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit”. Gjykata Administrative e Shkallës së parë me Vendimin nr. 80-2017-3056, datë 10.07.2017 ku është vendosur: Rrëzimi i kërkesë padisë dhe lënia në fuqi e vendimit të AK. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkalles së parë.
Çështja administrative me paditës ndërmarrjen “AMC” Sha, i paditur AK, me objekt: Pavlefshmëria e vendimit të KK nr. 59, datë 09.11.2007 “Për abuzimin me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme të shoqërive Albanian Mobile Communication Sha dhe Vodafone Albania Sha”. Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me këtë çështje, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke konfirmuar ligjshmërinë e vendimit të KK nr. 59, datë 09.11.2007. Kundër këtij vendimi pala paditëse “AMC” Sha, paraqiti ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kundër këtij vendimi ‘AMC’ paraqiti rekurs pranë Gjykatës së Lartë, e cila pasi e shqyrtoi, vendosi kthimin për rigjykim të kësaj çështjeje pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo Gjykata ka konfirmuar ligjshmërinë e vendimit të KK. Kundër këtij vendimi është bërë rekurs në gjykatën e Lartë.

4. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen "Tirana Lines", i paditur AK, me objekt "Kundërshtimin e vendimit të KK nr. 290, datë 23.07.2013 "Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes "Ferlut" Sha, "Tirana Lines" Shpk, "Alba Trans" Shpk, "Tirana Urban Trans" Sha dhe "Parku Urban të Udhëtarëve" Shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit, në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve, në qytetin e Tiranës". Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, me vendimin nr. 1547, datë 12.04.2017 vendosi rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e KK dhe kthimin e tij në titull ekzekutiv.
5. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen "Tirana Urban Trans", i paditur AK, me objekt kundërshtim i vendimit të KK nr. 290, datë 23.07.2013, për pjesën që i takon Paditësit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së ndërmarrjes, duke lënë në fuqi vendimin e AK. Kundër këtij vendimi, nga ana e ndërmarrjes është kryer ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, e cila me vendimin nr. 554, datë 17.03.2016 vendosi: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë paditësi, ndërmarrja "Tirana Urban Trans" Sha, dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
6. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen "NAZERI" SHRSF & "DEA" SHRSF, i paditur AK, me objekt shfuqizimi i vendimit të KK nr. 240, datë 26.07.2012 "Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve "Eurogjici Security" Shpk, "Toni Security" Shpk, "Eurogjici Security 1" Shpk, "Nazëri – 2000" Shpk dhe "Dea Security" Shpk për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike". Në lidhje me këtë çështje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi, nga ana e AK është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit, në lidhje me këtë çështje shpalli: mos-kompetencën lëndore në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs i padituri, AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
7. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen "AMC" Sha, i paditur: AK; me objekt anulim i vendimit të KK nr. 26 – 27, datë 02.12.2005 dhe 12.12.2005. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Lartë, pas rekursit të paraqitur nga AK, e cila pas shqyrtimit vendosi ta kthejë këtë çështje për rigjykim në Gjykatën e Apelit, Tiranë. Gjykata e Apelit, Tiranë në lidhje me këtë çështje shpalli mos-kompetencën lëndore, në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, e cila vendosi pranimin pjesërisht të padisë, duke pushuar gjykimin lidhur për vendimin e KK nr. 26, 02.10.2005 dhe duke pranuar padinë në lidhje me vendimin e KK nr. 27, 12.10.2005. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs AK dhe jemi në pritje të caktimit të datës së gjykimit.
8. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen "Ultra-Motors", i paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i vendimit të KK nr. 154, datë 01.10.2010 "Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve "Classic" sh.p.k, "Hyundai Auto Albania" sh.pk, "Noti" sh.p.k dhe "Ultra Motors" Shpk dhe vendosje gjobe ndaj tyre për kufizim të

konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja", lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Çështja ndodhet për shqyrtim në Dhomën e Këshillimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të datës së gjykimit.

9. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen "Ferlut", i paditur AK, me objekt kundërshtim i vendimit të KK nr. 290, datë 23.07.2013, për pjesën që i takon paditësit. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 4991, datë 10.06.2015 vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë i padituri, AK dhe jemi në pritje të datës së gjykimit.
10. Çështja administrative me paditës ndërmarrjet "Eurogjici Security" Shpk, "Eurogjici, Security 1" Shpk, "Toni Security" Shpk, i paditur AK, me objekt: Kundërshtim i vendimit të KK nr. 240, datë 26.07.2012. Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë me vendimin nr. 1400, datë 30.05.2016, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë i padituri, AK dhe jemi në pritje të datës së gjykimit.
11. Çështja administrative me paditës ndërmarrjen "Alba Trans" Shpk, i paditur AK, me objekt: Kundërshtim i vendimit 290, datë 23.07.2013 të KK, për pjesën që i takon paditësit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, vendosi të pranojë padinë e kësaj ndërmarrjeje. Kundër këtij vendimi nga ana e AK është kryer ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, në lidhje me këtë çështje shpalli moskompetencën lëndore, në zbatim të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. 2981, datë 11.07.2014 vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala e paditur, AK. Është zhvilluar një proces gjyqësor në dhomë këshillimi nga kjo gjykatë ku është vendosur kalimi në seancë gjyqësore.

Vlerësime ligjore të akteve normative ERE & ERRU

1. Vendim nr. 659, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje miratimin e një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik””.
2. Vendim nr. 593, datë 07.02.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Gjirrokastër” SHA”.
3. Vendim nr. 600, datë 15.03.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Poličan” SHA”.
4. Vendim nr. 602, datë 21.03.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Delvinë” SHA”.
5. Vendim nr. 628, datë 13.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Tropojë” SHA”.
6. Vendim nr. 629, datë 20.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Lushnjë” SHA”.
7. Vendim nr. 630, datë 20.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe” SHA”.
8. Vendim nr. 651, datë 10.10.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë” SHA”.
9. Vendimi nr. 658, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Himarë” SHA”.
10. Vendimi nr. 657, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Vlorë” SHA”.
11. Vendim nr. 656, datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Krujë” SHA”.
12. Vendim nr. 651, datë 10.10.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Berat Kuçovë” SHA”.
13. Vendimi nr. 630, datë 20.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe” SHA”.

14. Vendim nr. 629, datë 20.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Lushnjë” SHA”.
15. Vendim nr. 628, datë 13.06.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Tropojë” SHA”.
16. Vendim nr. 602, datë 21.03.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Delvinë” SHA”.
17. Vendim nr. 600, datë 15.03.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Poliçan” SHA”.
18. Vendim nr. 593, datë 07.02.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë” SHA”.

Plani Veprimit të Autoritetit të Konkurrencës			2020											2021											2022													
Nr.	Shtyllat e Ligjit	Mbikëqyrja e tregjeve tradicionale	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet
1	Neni 4 ose 9	Tregu i Telekomunikacioneve																																				
2	Neni 4 ose 9	Tregu Financiar (Banka dhe Sigurime, SFJB)																																				
3	Neni 4 ose 9	Tregu i Energjisë																																				
4	Neni 4 ose 9	Tregu i Hidrokarbureve																																				
5	Neni 4 ose 9	Tregu i Transportit (ajror, tokësor, detar, hekurudhor)																																				
6	Neni 4 ose 9	Tregu Audiovizual																																				
7	Neni 10-12	Kontrolli i Përqendrimeve																																				
8	Neni 9	Vlerësimi i tregjeve me të drejta ekskluzive dhe të vecanta																																				
9	Neni 9	Monitorimi i vazhdueshëm i tregjeve me pozitë dominuese																																				
Nr.	Shtyllat e Ligjit	Mbikëqyrja e tregjeve të reja	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet
1	Neni 41	Tregu Farmaceutik																																				
2	Neni 41	Tregu i Tregtisë elektronike																																				
4	Neni 41	Tregu Spitalor																																				
5	Neni 41	Tregu i ofrimit të arsimit të lartë																																				
6	Neni 41	Tregu i shërbimit stomatologjik																																				
9	Neni 10-12	Kontrolli i Përqendrimeve																																				
10	Neni 9	Vlerësimi i tregjeve me të drejta ekskluzive dhe të veçanta																																				
11	Neni 9	Monitorimi i vazhdueshëm i tregjeve me pozitë dominuese																																				
Nr.	Vlerësim ligjor i akteve normative		Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet
1	Vlerësim projekt akteve normative	Vlerësim i projekt ligjeve																																				
2	Vlerësim projekt akteve normative	Vlerësim i akteve nënligjore																																				
3	Vlerësim projekt akteve normative	Vlerësim i akteve normative																																				
4	Vlerësim projekt akteve normative	Programi Analitik i Projek-akteve të KM dhe Axxhenda e Kuvendit																																				
Nr.	Çështje për t'u Gjykuar		Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet
1	Çështje gjyqësore	Mbrojtja e çështjeve gjyqësore në të tre shkallët e Gjyqësorit Administrativ																																				
Nr.	Ekzekutimi i Vendimeve te KK		Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet
1		Ndjekja e procedurave pranë zyrës së përmbartimit																																				
Nr.	Zbatim i Projekteve		Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet
1	Projekti i IPA Twinning	Result 1: Improved legal framework and further approximation with the EU legislation																																				
2		Result 2: Strengthened administrative capacities of the ACA																																				
3		Result 3: Authority capacity to reach out to different relevant stakeholders increased																																				
4	Projekti i BERZH	Activity 1: Drafting and promoting the 5-year strategy for “Competition Advocacy and Communication”.																																				
5		Activity 2: Purchase of the econometric software STATA license and provision of training on the application of the software to competition analysis.																																				
6		Activity 3: Training on the application of Articles 101 and 102 of the TFEU with an assessment of relevant ECJ jurisprudence.																																				
7		Activity 4: Training on merger analysis based on significant impediment to effective competition test (SIEC).																																				
8		Activity 5: Study visits for the members of the Competition Commission and the staff members of ACA.																																				
Nr.	Advokacia e Konkurrencës		Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet
1		Promovimi i Strategjisë së Advokacisë 5 vjetare në bashkëpunim me BERZH																																				
Nr.	Përafrimi i legjislacionit		Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet
1	Përafrimi i legjislacionit	Shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9121/2003																																				
2	Përafrimi i legjislacionit	Përafrimi i akteve në zbatim të PKIE 2020-2022																																				
Nr.	Shtim dhe forcim i Kapaciteteve administrative		Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhjet
1		Krijimi i Drejtorisë së Vlerësimit Ekonomik (Chief Economist)																																				
2		Trajnimi i stafit ekzistues dhe stafit të ri																																				